



# EKSPLORIMI I SFIDAVE TË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE DHE MUNDËSIVE PËR KALIMIN NË EKONOMI NEUTRALE NDAJ KARBONIT NË KOSOVË

Shtator 2022

## **Tabela e përmbajtjes**

Përmbledhje ekzekutive	5
Hyrje	8
Shqyrtimi i literaturës	9
Opinionet rreth financimit prej institucioneve qendrore për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe për inkurajimin e dekarbonizimit.	31
Gjetjet nga diskutimet në grupe të fokusit	36
I. Perceptimet e përgjithshme të ndryshimeve klimatike dhe gjurmës së karbonit në Kosovë	37
II. Sfidat dhe përgjigjet e Kosovës ndaj ndryshimeve klimatike dhe gjurmës së karbonit	38
III. Vetëdijesimi i palëve të interesit për përpjekjet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare për ndryshimet klimatike dhe dekarbonizimin	42
IV. Cila është rruga përpara?	42
Përfundime dhe rekomandime	44
Lista e referencave	47
Aneksi I Metodologjia	48

## Lista e figurave

Figura 1 Deri në çfarë mase jeni të vetëdijshëm për kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit tuaj/të familjes suaj?	15
Figura 2 Deri në çfarë mase jeni të vetëdijshëm për kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit tuaj/të familjes suaj? – sipas moshës	16
Figura 3 Deri në çfarë mase jeni të vetëdijshëm për kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit tuaj/të familjes suaj? – sipas gjinisë	16
Figura 4 Deri në çfarë mase jeni të vetëdijshëm për kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit tuaj/të familjes suaj? - sipas përkatësisë etnike	17
Figura 5 Sa mendoni se i njihni të drejtat tuaja për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër?	17
Figura 6 Sa mendoni se i njihni të drejtat tuaja për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër? - sipas moshës	18
Figura 7 Sa mendoni se i njihni të drejtat tuaja për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër? - sipas gjinisë	18
Figura 8 Sa mendoni se i njihni të drejtat tuaja për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër? - sipas përkatësisë etnike	19
Figura 9 A mendoni se preket Kosovo nga ndryshimet klimatike?	19
Figura 10 A mendoni se preket Kosovo nga ndryshimet klimatike? - sipas moshës	20
Figura 11 A mendoni se preket Kosovo nga ndryshimet klimatike? - sipas gjinisë	Figure 12 A
mendoni se preket Kosovo nga ndryshimet klimatike? - sipas përkatësisë etnike	21
Figura 13 A keni dëgjuar për ndryshimet klimatike?	21
Figura 14 A keni dëgjuar për ndryshimet klimatike? - sipas moshës	22
Figura 15 A keni dëgjuar për ndryshimet klimatike? - sipas gjinisë	22
Figura 16 A keni dëgjuar për ndryshimet klimatike? - sipas përkatësisë etnike	23
Figura 17 Ku keni dëgjuar për ndryshimet klimatike?	24
Figura 18 Ku keni dëgjuar për ndryshimet klimatike? - sipas moshës	25
Figura 19 Ku keni dëgjuar për ndryshimet klimatike? - sipas gjinisë	25
Figura 20 Ku keni dëgjuar për ndryshimet klimatike? - sipas përkatësisë etnike	26
Figura 21 A mendoni se klima po ndryshon?	27
Figura 22 A mendoni se klima po ndryshon? - sipas moshës	27
Figura 23 A mendoni se klima po ndryshon? - sipas gjinisë	28
Figura 24 A mendoni se klima po ndryshon? - sipas përkatësisë etnike	29
Figura 25 Sa e rëndësishme është çështja e ndryshimeve klimatike për ju?	29
Figura 26 Sa e rëndësishme është çështja e ndryshimeve klimatike për ju? - sipas moshës	30
Figura 27 Sa e rëndësishme është çështja e ndryshimeve klimatike për ju? - sipas gjinisë	30
Figura 28 Sa e rëndësishme është çështja e ndryshimeve klimatike për ju? - sipas përkatësisë etnike	31
Figura 29 Nga kjo listë e çështjeve mjedisore që e prekin Kosovën, cila ju shqetëson më shumë ?	31
Figura 30 Nga kjo listë e çështjeve mjedisore që e prekin Kosovën, cila ju shqetëson më shumë ? - sipas moshës	32
Figura 31 Nga kjo listë e çështjeve mjedisore që e prekin Kosovën, cila ju shqetëson më shumë ?- sipas gjinisë	33

Figura 32 Nga kjo listë e çështjeve mjedisore që e prekin Kosovën, cila ju shqetëson më shumë? - sipas përkatësisë etnike	33
Figura 33 Çka mendoni se mund të ndihmojë për zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike ?	34
Figura 34 Çka mendoni se mund të ndihmojë për zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike ? - sipas moshës	34
Figura 35 Çka mendoni se mund të ndihmojë për zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike ? - sipas gjinisë	35
Figura 36 Çka mendoni se mund të ndihmojë për zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike? - sipas përkatësisë etnike	35
Figura 37 A do të mbështesnit financimin institucional (taksat që paguani ju) për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve klimatike, si ndotja e ajrit, tek popullsia e Kosovës?	36
Figura 38 A do të mbështesnit financimin institucional (taksat që paguani ju) për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve klimatike, si ndotja e ajrit, tek popullsia e Kosovës? - sipas moshës	37
Figura 39 A do të mbështesnit financimin institucional (taksat që paguani ju) për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve klimatike, si ndotja e ajrit, tek popullsia e Kosovës? - sipas gjinisë	37
Figura 40 A do të mbështesnit financimin institucional (taksat që paguani ju) për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve klimatike, si ndotja e ajrit, tek popullsia e Kosovës? - sipas përkatësisë etnike	38
Figura 41 A do t'i mbështesnit institucionet qendrore/komunën nëse do të shqiptonin gjoba për hedhje të mbeturinave dhe qeseve plastike ?	38
Figura 42 A do t'i mbështesnit institucionet qendrore/komunën nëse do të shqiptonin gjoba për hedhje të mbeturinave dhe qeseve plastike ? - sipas moshës	39
Figura 43 A do t'i mbështesnit institucionet qendrore/komunën nëse do të shqiptonin gjoba për hedhje të mbeturinave dhe qeseve plastike ? - sipas gjinisë	39
Figura 44 A do t'i mbështesnit institucionet qendrore/komunën nëse do të shqiptonin gjoba për hedhje të mbeturinave dhe qeseve plastike? - sipas përkatësisë etnike	40
Figura 45 A jeni të gatshëm të paguani tarifa më të larta për energjinë elektrike për hir të minimizimit të ndikimit të ndryshimeve klimatike tek gjeneratat e ardhshme ?	40
Figura 46 A jeni të gatshëm të paguani tarifa më të larta për energjinë elektrike për hir të minimizimit të ndikimit të ndryshimeve klimatike tek gjeneratat e ardhshme ? - sipas moshës	41
Figura 47 A jeni të gatshëm të paguani tarifa më të larta për energjinë elektrike për hir të minimizimit të ndikimit të ndryshimeve klimatike tek gjeneratat e ardhshme ? - sipas gjinisë	41
Figura 48 A jeni të gatshëm të paguani tarifa më të larta për energjinë elektrike për hir të minimizimit të ndikimit të ndryshimeve klimatike tek gjeneratat e ardhshme? – sipas përkatësisë etnike	42

## Përmbledhje ekzekutive

Ky hulumtim, duke përfshirë një anketë të Pulsit Publik, u porosit nga UNDP në Kosovë për të eksploruar perceptimet e qytetarëve rreth sfidave të ndryshimeve klimatike me të cilat përballet Kosova, dhe rreth mundësive dhe iniciativave për kalimin në një ekonomi neutrale ndaj karbonit. Tema trajtohet nga këndvështrimi i institucioneve qendrore të Kosovës, bizneseve, organizatave të shoqërisë civile dhe publikut të gjerë. Studimi ofron edhe detaje rreth njohurive dhe qëndrimeve të qytetarëve ndaj ndryshimeve klimatike dhe dekarbonizimit. Analiza mund të përdoret si input nga institucionet e Kosovës gjatë hartimit të politikave për mjedisin dhe klimën dhe për adresimin e sfidave që lidhen me ndryshimet klimatike.

Hulumtimi së pari vlerëson njohuritë për ndryshimet klimatike dhe perceptimet se si të zbutet ndikimi i tyre. Më pas ai fokusohet në politika të veçanta dhe masa zbutëse. Studimi, i cili u realizua në periudhën prill-maj 2022, kombinoi një anketë me 1300 të anketuar me diskutime në grupe të fokusit, duke përfshirë përfaqësues të institucioneve qendrore publike, organizatave të shoqërisë civile dhe bizneseve.

Gjetjet tregojnë se në përgjithësi publiku ka njohuri për konceptin e ndryshimeve klimatike, por ka konfuzion rreth ndikimit të tyre dhe si e prek kjo Kosovën. Pothuajse 70% e të rinjve (18 – 24) deklaruan se kanë pak njohuri për ndikimet e ndryshimeve klimatike në shëndetin e tyre. TV është një burim më i rëndësishëm informacioni, veçanërisht për pjesëmarrësit serbë të Kosovës (78%), të ndjekur nga 75% e pjesëmarrësve nga etnitë e tjera dhe 64% e shqiptarëve; rrjetet sociale janë burimi i dytë më i zakonshëm për të rriturit e rinj të të gjitha etnive (42%), por më pak të zakonshme për të moshuarit (0%).

Megjithëse publiku e njoh termin ‘ndryshime klimatike’, përgjigjet e tyre ndaj masave të mundshme për zbutjen e ndryshimeve klimatike tregojnë se ata nuk janë të vetëdijshëm se çka do të thotë në praktikë. Energjia e ripërtërishme u rendit si zgjidhja e dytë më e mirë për t’i zbutur ndryshimet klimatike, duke sugjeruar se publiku është i vetëdijshëm se djegia e derivateve fosile është shkak kyç i ndryshimeve klimatike. Vetëm një pakicë (31%) e të gjithë të anketuarve ishin të gatshëm të paguanin tarifa më të larta të energjisë elektrike për hir të minimizimit të ndikimeve të ndryshimeve klimatike tek gjeneratat e ardhshme, ndërsa 65% e të anketuarve thanë se nuk do të paguanin tarifa më të larta të energjisë elektrike. Ndërkohë, mes çështjeve mjedisore që i shqetësojnë më shumë shumica e pjesëmarrësve zgjedhën “menaxhimin e mbeturinave”, “hedhjen e mbeturinave”, “menaxhimin e mbeturinave të ngurta” dhe “ndotjen plastike”. Kështu, “menaxhimi më i mirë i mbeturinave” u rendit më lart si masë zbutëse, pavarësisht ndikimit të kufizuar real që ka në reduktimin e emetimeve të gazrave serë. Sikurse mungesa e vetëdijesimit, kjo sugjeron se publiku është i shqetësuar për çështjet mjedisore që janë më të dukshme në jetën e tyre të përditshme.

Pjesëmarrësit në diskutimet në grupe të fokusit duket se kanë perceptime dhe besime të ngjashme rreth ndryshimeve klimatike dhe gjurmës së karbonit në Kosovë. Perceptimet e tyre ndryshonin vetëm për sa i përket renditjes së ndotësve kryesorë dhe zgjidhjeve. Të gjithë kanë dëgjuar për ndryshimet klimatike dhe janë të vetëdijshëm për ndikimet e tyre negative, dhe për sfidat e Kosovës në lëvizjen drejt një të ardhmeje më të gjelbër me më pak efekte të ndryshimeve klimatike.

Diskutimet në grupe të fokusit me bizneset, institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile, nxjerrin në pah qëndrimet e mëposhtme.

» **Bizneset**

» **Biznese të vetë-deklaruara të gjelbra nga sektorë të ndryshëm**

- Nuk është bërë shumë për sa i përket dekarbonizimit, pastrimit të lumenjve dhe qasjes në ujë të pijshëm të sigurt.
- Është e rëndësishme të organizohen vizita studimore dhe të shkëmbehen njohuritë dhe shkathtësitë me biznese të tjera në Evropë.
- Çdo komunë ka nevojë për një ekspert të energjisë për t'i adresuar më mirë sfidat dhe për të ofruar zgjidhje. Duhet të bëhet një vlerësim i nevojave për të identifikuar nevojat komunale: kjo mund të nxisë instalimin e paneleve fotovoltaike apo edhe pompave të nxehtësisë, nëse është e mundur.
- Kosova duhet të zbatojë Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor si dhe ligjet përkatëse në fuqi.
- Ekziston nevoja për t'i kuptuar më mirë burimet hidrike dhe të erës përpara se të fillohet tranzicioni për heqjen e thëngjillit nga përdorimi.

» **Bizneset prodhuese**

- Kompanitë që operojnë me djegie të thëngjillit dhe ato të ndërtimitarisë janë ndotësit më të mëdhenj në Kosovë.

» **Biznese të tjera**

- Disa kompani prodhuese nuk kanë mekanizma për filtrim të ajrit dhe as institucionet qendrore dhe as vetë bizneset nuk janë të vetëdijshëm për emetimet e tyre të gazrave serë (GS) dhe ndotjen e ajrit, që nuk ka dyshim se e dëmtojnë mjedisin.
- Ndryshimet klimatike kanë sjellë rritje të sëmundjeve të ndryshme, ndërsa në qytetet ku ka ndotje të madhe të ajrit, shumë fëmijë kanë probleme me frymëmarrjen. Shumica e mbetjeve mjekësore të patrajtuara të Kosovës hidhen në deponi të rastit, duke dëmtuar mjedisin; çështje të tilla nuk janë të rregulluara ligjërisht.
- Në mungesë të landfillit të duhur apo zgjidhjeve të tjera, mbeturinat nga therja e bagëtive shtëpiake kanë ndikim të konsiderueshëm negativ në mjedis dhe emetojnë GS.
- Sfida shtesë janë edhe ndryshimet e shpeshta të temperaturës, ndërprerja e modeleve të rregullta të reshjeve dhe ndryshimi i përdorimit të tokës, për shembull nga tokë bujqësore në tokë për ndërtim.
- Prodhimi i energjisë elektrike është ndotësi më i madh. Edhe shpyllëzimi është çështje serioze.

» **Institucionet publike**

» **Institucionet lokale**

- Problemet më të mëdha janë termocentralet, projektet e ndërtimitarisë, mbetjet industriale (nga Mitrovica, Obiliq, Hani i Elezit dhe Drenasi) dhe menaxhimi i dobët i pyjeve.

- Mungesa e transportit të duhur publik rezulton në ndotje të ajrit.
- Ka pasur progres të mjaftueshëm në menaxhimin e mbeturinave. Por kërkohet përmirësim në trajtimin e ujërave të zeza në nivel kombëtar dhe lokal. Trajtimi i dobët i ujërave të zeza ndot lumenjtë dhe tokat bujqësore.

#### » **Institucionet qendrore**

- Emetimet e GS-ve janë ndër ndotësit kyç të mjedisit. Kosova duhet të fokusohet në dekarbonizimin e sektorit energjetik. Më saktësisht, fokusi duhet të jetë në mënyrat si të nxirren nga përdorimi lëndët djegëse fosile dhe të fillohet përdorimi i alternativave si burimet e ripërtërishme të energjisë.
- Për shkak të ndikimeve socio-ekonomike të COVID-19, ndryshimet klimatike nuk janë trajtuar si çështje urgjente.
- ndotës të tjerë kyç janë ujërat e zeza, përdorimi i materialeve ndotëse të ndërtimit (përfshirë silkaporin dhe pluhurin e aluminit), menaxhimi i dobët i landfilleve, bagëtitë shtëpiake dhe mbeturinat spitalore.
- Industria e prodhimitarisë është një tjetër ndotës kyç përmes gjenerimit të tepërt të mbetjeve, rrjedhjeve dhe përdorimit të tepërt të kullotave nga industria bujqësore.
- Vetëdijesimi i publikut për ndryshimet klimatike është shumë i ulët dhe duhet bërë më shumë për edukimin e të rinjve.
- Buxheti nuk është i përafuar siç duhet me dokumentet e politikave dhe objektivat politike, prandaj ndonjëherë objektivat nuk janë përmbushur.
- Institucionet qendrore kërkojnë më shumë staf për këtë sektor.

#### » **OJQ-të**

- Termocentralet dhe guroret janë ndër ndotësit më të mëdhenj.
- Edhe emetimet e makinave janë ndotës i rëndësishëm.
- Është shqetësues përparimi i ngadalshëm i Kosovës në respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.
- Linjiti mund të përdoret si pleh organik dhe kjo mund të hulumtohet më tej.

Një anketë publike zbuloi njohuritë dhe qëndrimet e mëposhtme rreth ndryshimeve klimatike dhe dekarbonizimit:

- Gjithsej 63% e pjesëmarrësve thanë se kishin dëgjuar për ndryshimet klimatike ndërsa 36% thanë se nuk kishin dëgjuar. Të rinjtë (18-24) janë më të vetëdijshëm (70%) për ndryshimet klimatike sesa grupmoshat e tjera. Televizioni (65%) duket të jetë burimi kryesor i informacionit në përgjithësi për të gjithë pjesëmarrësit, i ndjekur nga rrjetet sociale (27%).
- Më shumë se gjysma e të anketuarve (52%) e perceptojnë çështjen e ndryshimeve klimatike si me rëndësi, dhe 27% e perceptojnë atë si me shumë rëndësi. 53% e shqiptarëve të Kosovës e konsiderojnë çështjen e ndryshimeve klimatike si një çështje me rëndësi në krahasim me 26% të pjesëmarrësve serbë të Kosovës dhe 46% të pjesëmarrësve nga etnitë e tjera.
- 41% e të anketuarit pohojnë se dinë pak për kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre. Shqiptarët e Kosovës duken më të

vetëdijshëm për ndikimet e ndryshimeve klimatike në shëndetin e tyre, në krahasim me serbët e Kosovës dhe etnitë e tjera.

- Të anketuarit e grupmoshës 45-54 vjeç duket se kanë më shumë njohuri për të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër sesa grupmoshat e tjera.
- Është i lartë vetëdijesimi i qytetarëve nëse Kosova është e prekur nga ndryshimet klimatike, ku 64% deklarojnë se Kosova është deri diku e ndikuar nga efektet e ndryshimeve klimatike dhe 18% thonë se Kosova është e prekur shumë nga ndryshimet klimatike.
- Të gjitha etnitë duket se kanë perceptime të ngjashme për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë: 64% e shqiptarëve të Kosovës, 49% e serbëve të Kosovës dhe 53% e etnive të tjera besojnë se Kosova është deri diku e ndikuar nga ndryshimet klimatike.
- Të dhënat tregojnë se pjesëmarrësit nuk i diskutojnë shumë ndryshimet klimatike me familjarët dhe shoqërinë e tyre.
- Pothuajse 70% e të anketuarve besojnë se moti po ndryshon, ndërsa 27% besojnë se nuk po ndryshon dhe pjesa tjetër nuk e di. 72% e shqiptarëve të anketuar mendojnë se moti po ndryshon, krahasuar me 30% të serbëve dhe 56% të pjesëmarrësve nga etnitë e tjera.
- Ndotja e ajrit konsiderohet si çështja më urgjente mjedisore (26%), e ndjekur nga ndotja e ujërave nëntokësore, ujit të pijshëm dhe lumenjve (18%), mbeturinat (11%), menaxhimi i dobët i mbeturinave (8%), përdorimi i automjeteve të vjetra si mjete të transportit (6%), termocentralet (4%), ujërat e zeza (4%), menaxhimi i mbeturinave të ngurta (3%), vërshimet (3%) dhe përdorimi i plastikës (3%).
- Për shqiptarët e Kosovës (26%) dhe të anketuarit e etnive të tjera (28%), ndotja e ajrit mbetet shqetësimi kryesor, ndërsa vetëm 17% e pjesëmarrësve serbë renditën ndotjen e ajrit si shqetësimin kryesor mjedisor për ta. Ndotja e ujit, ujit të pijshëm dhe lumenjve është renditur si shqetësimi kryesor për pjesëmarrësit serbë të Kosovës (30%), krahasuar me 17% të shqiptarëve të Kosovës dhe 16% të të anketuarve nga etnitë e tjera.
- Shumica e të anketuarve (70%) do ta mbështesnin përdorimin e fondeve publike për të vlerësuar ndikimet e ndryshimeve klimatike në Kosovë.
- Një shumicë e qartë (77%) thanë se do ta mbështesnin shqiptimin e gjobave për hedhjen e mbeturinave dhe qeseve plastike.
- 31% e të anketuarve pohuan se do të ishin të gatshëm të paguanin më shumë për energjinë elektrike për hir të minimizimit të ndikimit të ndryshimeve klimatike tek gjeneratat e ardhshme.

## Hyrje

Në nivel global, ndryshimet klimatike janë sfida më e madhe zhvillimore me të cilën po përballet njerëzimi sot. Është e domosdoshme që publiku i gjerë të kuptojë se si ndryshimet klimatike ndikojnë tek ata dhe çfarë po bëjnë institucionet e tyre për ta zbutur këtë kërcënim. Kosova përballet me të njëjtat çështje dhe sfida klimatike si kudo tjetër. Prandaj, ky raport



ofron një studim specifik për Kosovën në lidhje me besimet, perceptimet dhe qëndrimet rreth ndryshimeve klimatike. Raporti eksploron nëse po ndërmerren veprimet e duhura për t'i luftuar ndryshimet klimatike dhe për t'i identifikuar zonat kritike për intervenim. Kjo anketë shqyrton edhe shqetësimet dhe perceptimet në lidhje me efektet e ndryshimeve klimatike në shëndet dhe risqe të tjera që lindin prej tyre.

Kosova mbështetet në dy termocentrale të vjetruara me thëngjill të cilat çlirojnë sasi të konsiderueshme të dioksidit të karbonit dhe sasi më të vogla të metanit dhe oksidit të azotit. Më shumë se 95% e prodhimit vendas të energjisë elektrike vjen nga këto termocentrale me thëngjill. Përveçse nuk plotësojnë vazhdimisht kërkesën e brendshme, ato janë jo të besueshme dhe kontribuojnë ndjeshëm në ndotjen e ajrit. Ndërkohë, transporti është përgjegjës për pjesën e dytë më të madhe të emetimeve të gazrave serë (GS). Numri i lartë i makinave të vjetruara dhe mungesa e transportit publik të besueshëm kontribuojnë si në ndotjen e konsiderueshme të ajrit nga grimcat ashtu edhe në ndryshimet klimatike nëpërmjet emetimeve të dioksidit të karbonit. Edhe pse ka mungesë të të dhënave të besueshme, sektori me kontributin e dytë më të lartë në emetimet e GS-ve në Kosovë është bujqësia, pylltaria dhe ndryshimi i përdorimit të tokës. Këto ndiqen nga sektori i mbeturinave dhe emetimet nga industria dhe prodhimtaria. Vetëm toka pyjore është absorbues neto i emetimeve të GS-ve, por ndryshimi i përdorimit të tokës dhe shpyllëzimi po e pengojnë këtë efekt pozitiv.

Ky raport paraqet një pasqyrë të perceptimeve rreth ndryshimeve klimatike dhe sfidave që ato sjellin në Kosovë, nga këndvështrimi i publikut, institucioneve qendrore dhe lokale dhe komunitetit të biznesit. Raporti ofron gjithashtu të dhëna rreth perceptimeve për ndikimet e ndryshimeve klimatike në shëndet dhe për zgjidhjet e mundshme. Raporti mat edhe vetëdijësimin dhe njohuritë e palëve të interesit për iniciativat për ndryshimet klimatike në nivel lokal, kombëtar dhe global. Raporti synon të eksplorojë opsionet për zbutjen e ndikimeve negative të ndryshimeve klimatike, duke ndihmuar në identifikimin e hendekëve dhe zonave për intervenime me politika ose teknike duke ofruar rekomandime nga diskutimet në grupe të fokusit.

Gjetjet ndahen në tre nënseksione: njohuri dhe vetëdijësim për ndryshimet klimatike dhe dekarbonizimin; opinionet për zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike; dhe opinionet për përdorimin e fondeve qendrore për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe për përshpejtimin e dekarbonizimit. Për të dhënë detaje të mëtejshme, elemente të hulumtimit cilësor janë përfshirë në bazë të diskutimeve në grupe të fokusit. Gjetjet e grupeve të fokusit ndahen sipas palëve të interesit, duke përfshirë institucionet qendrore, institucionet lokale, sektorë të ndryshëm të komunitetit të biznesit dhe shoqërinë civile. Ky raport shërben si bazament për planifikimin e intervenimeve të ardhshme për trajtimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë.

## Shqyrtimi i literaturës

Ndryshimet klimatike u referohen ndryshimeve afatgjata të temperaturës dhe modeleve të motit.<sup>1</sup> Përveç thyerjeve që shkaktojnë në jetën e kafshëve, ndryshimet klimatike përkthehen edhe në thyerje në shëndetin e njeriut. Djegia e lëndëve djegëse fosile është shtytësi kryesor

---

<sup>1</sup>Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, NENI 1 PËRKUFIZIMET

i ndryshimeve klimatike. Kalimi i prodhimit të energjisë në burime të ripërtërishme si dielli ose era do t'i reduktojë emetimet që shkaktojnë ndryshime klimatike.<sup>2</sup>

De karbonizimi nënkupton konvertimin në një sistem ekonomik që i redukton dhe kompenzon në mënyrë të qëndrueshme emetimet e dioksidit të karbonit (CO<sub>2</sub>). Synimi aktual i de karbonizimit është të eliminohen të gjitha emetimet e dioksidit të karbonit.<sup>3</sup> Për ta arritur këtë strategji globale dhe caqet detyruese shoqëruese, çdo vend është i detyruar të bëjë pjesën e tij dhe në këtë mënyrë t'i zvogëlojë efektet e ndryshimeve klimatike. Megjithatë, vetëm me përpjekje të bashkërenduara dhe afatgjata ndërkombëtare mund t'i trajtojmë me sukses shkaqet dhe pasojat e ndryshimeve klimatike.

Në vitin 2015, liderët botërorë dhe nënshkruesit e Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC)<sup>4</sup> u mbledhën në Paris për të nënshkruar Marrëveshjen historike të Parisit, duke u angazhuar për ta mbajtur ngrohjen globale nën 2.0°C dhe për të vazhduar përpjekjet për ta kufizuar më tej rritjen e temperaturës në 1.5°C. Marrëveshja shërben si udhërrëfyes për ndryshim, duke theksuar rëndësinë dhe rolin e qeverive, qyteteve, korporatave dhe investitorëve për të marrë pjesë në këtë ndryshim revolucionar.<sup>5</sup> Megjithatë, hulumtimet sugjerojnë se megjithëse ulja në 2.0°C do të ishte një arritje e jashtëzakonshme, shanset që kjo të arrihet janë vetëm 50%. Ka 50% shanse që të tejkalohet temperatura e parashikuar nëse ndiqet strategjia e treguar e emetimeve.<sup>6</sup> 2020 ishte viti më i nxehtë i regjistruar.<sup>7</sup>

Duke kaluar në një ekonomi të pastër, qarkore, duke ngadalësuar ndryshimet klimatike, duke rikthyer humbjen e biodiversitetit dhe duke ulur ndotjen, Marrëveshja e Gjelbër Evropiane<sup>8</sup> synon të arrijë neutralitetin ndaj karbonit deri në vitin 2050 dhe të rrisë eficiencën e burimeve.<sup>9</sup> Ndërkohë, Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) është në qendër të përpjekjeve globale, duke ofruar një kornizë për qeveritë që të bashkëpunojnë në luftën kundër ndryshimeve klimatike, bazuar në parimin e "përgjegjësisë dhe kapaciteteve të përbashkëta por të diferencuara, nën dritën e rrethanave të ndryshme

---

<sup>2</sup>Kombet e Bashkuara, Veprimi për Klimën, marrë nga: <https://www.un.org/en/climatechange/what-is-climate-change>

<sup>3</sup>Po aty.

<sup>4</sup>Joachim, H., Cramer., Wolfgang, et al, Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), Simpoziumi Ndërkombëtar për Stabilizimin e Përqendrimeve të Gazrave Serë, Shmangia e Ndryshimeve të Rrezikshme Klimatike, 2005

<sup>5</sup>UNFCCC, Marrëveshja e Parisit, 2015, marrë nga [https://unfccc.int/sites/default/files/english\\_paris\\_agreement.pdf](https://unfccc.int/sites/default/files/english_paris_agreement.pdf)

<sup>6</sup>Analitika e Klimës, Gjurmuesi i Veprimit për Klimën, Përditësimi Global i Parashikimeve të Ngrohjes, maj 2021

<sup>7</sup>Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, OKB, marrë nga <https://www.un.org/sustainabledevelopment/climate-change/>

<sup>8</sup>Bashkimi Evropian, Marrëveshja e Gjelbër Evropiane, dhjetor 2019, marrë nga [https://ec.europa.eu/clima/eu-action/european-green-deal\\_en](https://ec.europa.eu/clima/eu-action/european-green-deal_en)

<sup>9</sup>Kalim në të Gjelbër, Marrëveshja e Gjelbër me BE-në – një udhërrëfyes drejt ekonomive të qëndrueshme, marrë nga <https://www.switchtogreen.eu/the-eu-green-deal-promoting-a-green-notable-circular-economy/>

kombëtare”.<sup>10</sup> Nën ombrellën e UNFCCC, negociatat në mbarë botën janë zhvilluar që nga vitet 1990 me synimin për të rritur veprimin ndërkombëtar për ndryshimet klimatike.<sup>11</sup>

Raporti i pestë i Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC) arriti në përfundimin se Ballkani Perëndimor do të përjetojë një ndikim drastik në ndryshimet e variablave klimatike: rritja aktuale e vëzhguar e temperaturës prej 1.2°C do të shkojë 1.7 - 4.0°C në varësi të rrjedhave globale të emetimeve të GS-ve. Edhe Kosova do të përjetojë rritje të temperaturave, ndryshime në modelet e reshjeve dhe ndryshime në variablat përkatës klimatike, duke çuar në rritjen e intensitetit dhe shpeshtësisë së zjarreve në pyje, thatësirave, erozionit të tokës dhe vërshimeve. Në të njëjtën kohë, Ballkani Perëndimor mund të luajë rol vendimtar në uljen e emetimeve të GS-ve nga aktivitetet antropogjene që mbeten faktori themelor për ndryshimet klimatike. Edhe pse emetimet e përgjithshme për kokë në rajon janë më të ulëta në krahasim me Evropën Perëndimore, varësia e rajonit nga djegia e derivateve fosile për sektorin energjetik mbetet sfidë për rrugën drejt dekarbonizimit. Rajoni ka potencial për zbutjen e ndryshimeve klimatike nëse i nënshtrohet një tranzicioni drejt energjisë së pastër. Emetimet totale të GS-ve në Kosovë arritën në 9.5 Mt ekuivalent të CO<sub>2</sub> në vitin 2008, vetëm për të përjetuar një rritje tjetër prej 5.2% deri në vitin 2015 kur emetimet ishin 10 Mt ekuivalent të CO<sub>2</sub>. Vendet në Ballkanin Perëndimor tashmë po përballen me vështirësi, duke përfshirë rritjen e konsumit të energjisë gjatë verës, mungesën e ujit të pijshëm veçanërisht gjatë verës, thatësirat dhe valët e të nxehtit. Kosova dhe vendet e tjera të rajonit raportohet se operojnë disa prej termocentraleve më ndotëse në Evropë, dhe transporti dhe infrastruktura e saj energjetike kanë nevojë të dëshpëruar për modernizim. Si rezultat i mbështetjes së tepërt të tyre në lëndët djegëse fosile për rrjetin e energjisë, sistemet jo efikente të transportit dhe automjetet e vjetëruara, vendet si Kosova vuajnë nga ndotja e rëndë e ajrit urban dhe bllokimi i trafikut.<sup>12</sup>

Me këtë trend të rritjes së emetimeve të GS-ve dhe cenueshmërisë klimatike, Kosova e gjen veten në një pozitë që kërkon që veprimi klimatik të jetë në ballë të politikës kombëtare. Teksa Kosova nuk është palë e marrëveshjes së Parisit dhe as nënshkruese e UNFCCC, ajo është plotësisht e përkushtuar ndaj Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (GAWB). Qëllimi kryesor i GAWB është të arrijë neutralitetin ndaj karbonit deri në vitin 2050 dhe të përafrohet me elementët kyç të Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane. Si nënshkruese e Deklaratës së Sofjes, Kosova është plotësisht e përkushtuar për arritjen e këtyre objektivave. Kosovës aktualisht i mungon infrastruktura ligjore, dhe për rrjedhojë nuk ka bazë ligjore për Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) siç kërkohet nga Komuniteti i Energjisë. Por Ligji i parë për Ndryshimet Klimatike pritet të miratohet deri në fund të vitit 2022; kjo do të përgatisë terrenin për legjislacionin dytësor për të rregulluar procese të tilla si tregtimi i karbonit dhe gjithashtu do të hapë rrugën për ta ndërtuar në mënyrë koherente infrastrukturën teknike që do të informojë politikën e lidhura me klimën.

Deri më tani, Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2018-2028 është dokumenti i vetëm i politikave që i jep orientim agjendës së Kosovës për ndryshimet klimatike, por fokusi i saj

---

<sup>10</sup> Grupi për Strategji, Përpjekjet e Singaporit dhe ndërkombëtare, marrë nga <https://www.nclimatechanges.gov.sg/singapores-climate-action/singapore-and-international-efforts/>

<sup>11</sup> Po aty.


<sup>12</sup> Banka Botërore, Kosovë - Një e ardhme me Transport të Gjelbër dhe Ajër të Pastër, 2019

parashihet të ndryshojë pas miratimit të Ligjit të ri për Ndryshimet Klimatike.<sup>13</sup> Siç është, strategjia trajton kapacitetin e Kosovës për të përmbushur detyrimet e ardhshme ndaj UNFCCC-së dhe BE-së, dhe reduktimin e GS-ve përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, efijencës së energjisë dhe energjisë së ripërtërishme. Për sa i përket përshtatjes, ajo fokusohet në 1) përmirësimin dhe zhvillimin e mekanizmave të rinj për reduktimin e riskut nga fatkeqësitë, 2) forcimin e kapaciteteve të komuniteteve të cenueshëm dhe 3) rritjen e kapacitetit të palëve të interesit për të integruar përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në proceset e zhvillimit lokal dhe kombëtar.

## Njohuritë e qytetarëve për ndryshimet klimatike dhe dekarbonizimin

Ndikimi i ndryshimeve klimatike në ngjarjet ekstreme të motit dhe në shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve është njohur prej kohësh. Prandaj, të anketuarve iu kërkua fillimisht të vlerësonin njohuritë dhe vetëdijesimin e tyre për kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit. Shumica e të anketuarve (41%) kanë deklaruar se dinë pak për këtë temë, 33% kanë thënë se kanë njohuri mesatare, ndërsa vetëm 9% e të anketuarve kanë pohuar se dinë shumë për këtë çështje. 17% thanë se nuk kanë njohuri.


Figura 1 Deri në çfarë mase jeni të vetëdijshëm për kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit tuaj/të familjes suaj?



Të dhënat tregojnë se moshë nuk është faktor në përcaktimin e njohurive dhe vetëdijesimit për kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit. Të gjitha grupmoshat duket se kanë nivele të ngjashme informacioni për këtë temë.


Figura 2 Deri në çfarë mase jeni të vetëdijshëm për kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit tuaj/të familjes suaj? - sipas moshës

<sup>13</sup> Po aty.




Zbërthimi i mëtejshëm i të dhënave tregon se edhe gjinia bën pak dallim në vetëdijesimin për kërcënimet e mundshme mjedisore: 16% e meshkujve dhe 18% e femrave deklaruan se nuk kanë njohuri, 43% e meshkujve dhe 40% e femrave thanë se dinin pak, 32% e meshkujve dhe 33% e femrave deklaruan njohuri mesatare, dhe po aq përqindje e meshkujve dhe femrave (9%) pohuan se dinin shumë për këtë temë.

Figura 3 Deri në çfarë mase jeni të vetëdijshëm për kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit tuaj/të familjes suaj? - sipas gjinisë




Shqiptarët e Kosovës në përgjithësi pohojnë se janë të vetëdijshëm për kërcënimet mjedisore, më shumë sesa serbët dhe pjesëmarrësit e etnive të tjera.

Figura 4 Deri në çfarë mase jeni të vetëdijshëm për kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit tuaj/të familjes suaj? - sipas përkatësisë etnike




Perceptimi i qytetarëve për njohuritë dhe vetëdijesimi i tyre për të drejtat e tyre për një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër nuk ndryshon shumë nga pyetja për ndikimet në shëndet. 19% e të anketuarve kanë pohuar se nuk kanë njohuri, 41% kanë thënë se dinë pak, 26% kanë thënë se kanë njohuri mesatare dhe në fund 15% kanë pohuar se dinë shumë për këtë temë.

Figura 5 Sa mendoni se i njihni të drejtat tuaja për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër?




Të anketuarit e grupmoshës 45-54 vjeç duket se kanë më shumë njohuri për të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, ku vetëm 13% e tyre deklarojnë se nuk kanë njohuri për këtë të drejtë, 43% se kanë pak njohuri, 25% që kanë njohuri mesatare dhe 19% se dinë shumë për të. Në mënyrë të ngjashme, vetëm 16% e grupit më të ri (18-24) thanë se nuk kanë njohuri, ndjekur nga 43% që pohuan se kanë pak njohuri, 24% që thanë se kishin njohuri mesatare dhe në fund 17% që pohuan se dinë shumë për të.

Figura 6 Sa mendoni se i njihni të drejtat tuaja për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër? - sipas moshës




Të dhënat nuk tregojnë dallime të rëndësishme midis meshkujve dhe femrave në njohuritë për të drejtën për një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Për shembull, 20% e femrave thanë se nuk kanë njohuri për këtë të drejtë, krahasuar me 17% të meshkujve. 38% e femrave pjesëmarrëse deklaruan se dinë pak për këtë të drejtë, krahasuar me 43% të meshkujve. 27% e femrave thanë se kanë njohuri mesatare për këtë temë, krahasuar me 24% të meshkujve. Për fundi, 16% e meshkujve dhe 15% e femrave pohuan se dinin shumë për këtë temë.

Figura 7 Sa mendoni se i njihni të drejtat tuaja për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër? - sipas gjinisë




Ashtu si në pyetjen për njohjen e kërcënimeve të mundshme mjedisore ndaj shëndetit, shqiptarët deklarojnë nivele më të larta të vetëdijesimit për të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, ku vetëm 17% e tyre deklarojnë se nuk kanë njohuri për këtë temë. Kjo krahasohet me vlerën shqetësuese prej 39% të pjesëmarrësve serbë dhe 35% nga etnitë e tjera.

Figura 8 Sa mendoni se i njihni të drejtat tuaja për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër? - sipas përkatësisë etnike



Është i lartë vetëdijesimi i qytetarëve nëse Kosova është e prekur nga ndryshimet klimatike, me 64% që besojnë se Kosova është deri diku e ndikuar dhe 18% thonë se Kosova është e prekur shumë. Nga ana tjetër, 16% besojnë se Kosova është vetëm pak e prekur, dhe 3% besojnë se është shumë pak e prekur.


Figura 9 A mendoni se preket Kosovo nga ndryshimet klimatike?



Të anketuarit e të gjitha moshave duket se mendojnë në mënyrë të ngjashme sa i përket ndikimit të ndryshimeve klimatike në Kosovë. Vetëm 18% e të moshuarve (>65), 23% e grupmoshës 55-64 vjeç, 20% e të rinjve (25-34) dhe 18% e të rinjve (18- 24), besojnë se Kosova është e ndikuar shumë nga ndryshimet klimatike. Shumica e pjesëmarrësve, me ndryshime të vogla në mes të grupmoshave, besojnë se Kosova është deri diku e prekur nga ndryshimet klimatike. Kjo tregon se konsensusi i përgjithshëm është i pranishëm në të gjitha grupmoshat se ndryshimet klimatike janë më shumë se thjesht një koncept. Megjithatë, fakti që një shumicë e konsiderueshme u përgjigj “deri diku” në këtë pyetje tregon se ka një konfuzion se çfarë janë ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe se prekin ato Kosovën.




Figura 10 A mendoni se preket Kosovo nga ndryshimet klimatike? - zbërthyer sipas moshës




Meshkujt dhe femrat duket se mendojnë njësoj për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë. 20% e meshkujve mendojnë se po ndikon shumë, 64% mendojnë se po ndikon deri diku, 15% mendojnë se po ndikon pak dhe 2% mendojnë se po ndikon shumë pak. Në mënyrë të ngjashme, 16% e femrave mendojnë se ndryshimet klimatike po ndikojnë shumë në Kosovë, 63% mendojnë se po ndikojnë deri diku, 17% pohuan se po ndikojnë pak dhe 4% mendojnë se po ndikojnë shumë pak.

Figura 11 A mendoni se preket Kosovo nga ndryshimet klimatike? - sipas gjinisë




Të gjitha etnitë duket se kanë besime të ngjashme për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë. Për shembull, 64% e shqiptarëve, 49% e serbëve dhe 53% e etnive të tjera besojnë se Kosova është deri diku e prekur nga ndryshimet klimatike, ndërsa vetëm 2% e pjesëmarrësve shqiptarë, 6% e pjesëmarrësve serbë dhe 11% e të anketuarve nga etnitë e tjera besojnë se Kosova është shumë pak e prekur nga ndryshimet klimatike.

Figura 12 A mendoni se preket Kosovo nga ndryshimet klimatike? - sipas përkatësisë etnike



Në pyetjen nëse kanë dëgjuar për ndryshimet klimatike, shumica e të anketuarve (63%) kanë thënë se kanë dëgjuar për to, ndërsa 36% kanë thënë se nuk kanë dëgjuar për to.

Figura 13 A keni dëgjuar për ndryshimet klimatike?



Edhe pse të rinjtë (18-24) deklaruan se kanë pak njohuri për ndikimin e ndryshimeve klimatike në shëndetin e tyre, shumica dërrmuese e tyre – afërsisht 70% – kanë dëgjuar për to. Kjo është një gjetje pozitive, marrë parasysh se të rinjtë përbëjnë shumicën e popullsisë në Kosovë dhe kanë një obligim të fortë për të mbrojtur mjedisin dhe për të promovuar jetesë të qëndrueshme. Megjithatë, grupet e tjera treguan përqindje jo shumë larg kësaj, nga 61-63%. Për më tepër, në epokën moderne me qasje të shpejtë në informacionin global, rezultatet tregojnë se grupmosha e re merr lajme dhe mobilizim të vazhdueshëm për vetëdijësimin për ndryshimet klimatike dhe veprimin ndaj klimës. Megjithatë, mospërputhja mes përgjigjes së tyre ndaj dëgjimit për ndryshimet klimatike dhe njohjes së ndikimeve të ndryshimeve klimatike në shëndetin e tyre tregon se ata vetëm sa i marrin lajmet pa analiza të mëtejshme të thelluara. Përfshirja e shkencës së ndryshimeve klimatike dhe politikave klimatike në kurrikulën e sistemit arsimor, do të ndihmonte në pakësimin e këtyre mospërputhjeve.

Figura 14 A keni dëgjuar për ndryshimet klimatike? – sipas moshës





Figura 15 për zbërthimin sipas gjinisë tregon se, përsëri, gjinia nuk duket të jetë faktor përcaktues në vetëdijesimin, njohuritë ose qasjen në informacion rreth ndryshimeve klimatike. 65% e meshkujve dhe 62% e femrave thonë se kanë dëgjuar për të.

Figura 15 A keni dëgjuar për ndryshimet klimatike? - sipas gjinisë



Në mesin e shumicës së etnive, shumica e pjesëmarrësve kanë dëgjuar për ndryshimet klimatike: 65% e shqiptarëve dhe 53% e të anketuarve nga etnitë e tjera. Megjithatë, shifra për pjesëmarrësit serbë është mjaft më e ulët, me më pak se gjysmën (38%) që thonë se kanë dëgjuar për ndryshimet klimatike.

Figura 16 A keni dëgjuar për ndryshimet klimatike? - sipas përkatësisë etnike





Figura 17 (më poshtë) tregon mjetet me të cilat qytetarët dëgjojnë për ndryshimet klimatike. Televizioni (65%) është më i zakonshmi, ndoshta sepse fatkeqësitë mjedisore shfaqen më së shpeshti dhe në mënyrë efektive si imazhe televizive. Pas TV, rrjetet sociale (27%) janë burimi i dytë më i zakonshëm. Kjo është e pritshme, marrë parasysh përhapjen e rrjeteve sociale në mjedisin informativ të shumë qytetarëve. Imazhet në TV dhe rrjete sociale u ndihmojnë qytetarëve të shohin në kohë reale dëmin e shkaktuar nga ndryshimet klimatike, dhe kështu janë më të fuqishme sesa bisedat. Të dhënat tregojnë se pjesëmarrësit nuk e diskutojnë shumë ndikimin e ndryshimeve klimatike me familjarët dhe shoqërinë e tyre: vetëm 5% e të anketuarve thonë se kanë dëgjuar për ndryshimet klimatike në këtë mënyrë. Për fundi, vetëm 2% e të anketuarve thanë se kanë lexuar për ndryshimet klimatike në internet.

Figura 17 Ku keni dëgjuar për ndryshimet klimatike?



Zbërthimi i të dhënave sipas moshës sugjeron se burimi i informacionit për ndryshimet klimatike ndjek norma më të gjera të zakoneve të përdorimit të mediave dhe kohës së lirë. 90% e grupit më të vjetër (>65) dhe 93% e atyre të moshës 55-64 vjeç thonë se kanë dëgjuar për ndryshimet klimatike përmes televizionit; shifrat janë 52% e të rinjve në moshë madhore (nga 25-34) dhe 49% e të rinjve (18-24).

Rrjete sociale janë burimi i dytë më i zakonshëm për të rriturit e rinj dhe më pak i zakonshëm për të moshuarit. 42% e të rinjve (18-24) dhe 41% e të rinjve në moshë madhore (25-34) thanë se kanë dëgjuar për ndryshimet klimatike përmes rrjeteve sociale. Nga ana tjetër, rrjetet sociale ishin burimi për vetëm 5% të pjesëmarrësve në grupmoshën 55-64 vjeç dhe 0% të të moshuarve (>65).

Figura 18 Ku keni dëgjuar për ndryshimet klimatike? - sipas moshës






Figura 19 nuk tregon ndonjë ndryshim domethënës në mënyrën se si meshkujt dhe femrat dëgjojnë për ndryshimet klimatike.

Figura 19 Ku keni dëgjuar për ndryshimet klimatike? - sipas gjinisë



Televizioni është një burim më i rëndësishëm i informacionit për pjesëmarrësit serbë, ku 78% e tyre konfirmojnë se kanë dëgjuar për ndryshimet klimatike përmes TV-së, të ndjekur nga 75% e pjesëmarrësve nga etnitë e tjera dhe 64% e shqiptarëve. Rrjetet sociale janë burimi i dytë më i zakonshëm për të gjitha etnitë, por me një bilanc të ndryshëm: 28% e shqiptarëve pohojnë se kanë dëgjuar për ndryshimet klimatike kryesisht përmes rrjeteve sociale, të ndjekur nga serbët (19%) dhe etnitë e tjera (19%).

Figura 20 Ku keni dëgjuar për ndryshimet klimatike? - sipas përkatësisë etnike




## Opinionet e qytetarëve për zbutjen e ndryshimeve klimatike

Për t'i parandaluar më mirë fatkeqësitë mjedisore, qytetarët duhet ta ndryshojnë sjelljen e tyre në lidhje me mjedisin. Kjo do të kontribuonte në zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike të cilat tashmë mund të përjetojnë përmes temperaturave më ekstreme, ndryshimeve në shpeshësinë apo sasinë e shirave dhe stuhive më ekstreme.


69.7% e të anketuarve besojnë se klima po ndryshon, ndërsa 27.1% besojnë se nuk po ndryshon dhe 3.2% ose nuk e dinë ose kanë refuzuar të përgjigjen.

Figura 21 A mendoni se klima po ndryshon?




Të dhënat e zërthyera sipas moshës, siç shihet në figurën më poshtë, nuk tregojnë dallime të rëndësishme mes grupmoshave. Përafërsisht 70% e të anketuarve nga të gjitha grupmoshat mendojnë se klima po ndryshon.

Figura 22 A mendoni se klima po ndryshon? - sipas moshës




Kur bëhet fjalë për dallimet gjinore, 75% e meshkujve besojnë se klima po ndryshon, krahasuar me 65% të femrave.

Figura 23 A mendoni se klima po ndryshon? - sipas gjinisë



Të dhënat tregojnë një dallim domethënës në vetëdijesimin për ndryshimet klimatike ndërmjet etnive: rreth 72% e shqiptarëve mendojnë se klima po ndryshon, krahasuar me 30% të serbëve dhe 56% të pjesëmarrësve nga etnitë e tjera. Kjo mund të lidhet me mjetet e tyre ku marrin informacion. Televizioni është marginalisht burim më i rëndësishëm i informacionit për pjesëmarrësit serbë, ku 78% e tyre konfirmojnë se kanë dëgjuar për ndryshimet klimatike përmes TV-së. Krahasuar me rrjetet sociale apo leximin e artikujve në internet, televizioni lokal ka prirje t'u japë më pak mbulim ndryshimeve klimatike. Informacioni në rrjetet sociale ose internet rifreskohet me ritëm më të shpejtë dhe arrin audiencë më të madhe. Sistemi arsimor në Kosovë ofron kurrikula të harmonizuara për të gjitha etnitë, por në praktikë mund të ketë dallime. Mungesa e arsimit cilësor dhe e kurrikula që nuk përfshin mësim mbi ekologjinë dhe shkencën e klimës mund të kontribuojë në dallimet në vetëdijesimin për ndryshimet klimatike ndërmjet etnive.

Figura 24 A mendoni se klima po ndryshon? - sipas përkatësisë etnike



Pjesëmarrësit u pyetën gjithashtu se sa rëndësi kanë ndryshimet klimatike për ta. Më shumë se gjysma e të anketuarve (52%) e perceptojnë çështjen e ndryshimeve klimatike si me rëndësi, dhe 27% si me shumë rëndësi. Nga ana tjetër, 16% e konsiderojnë çështjen as me rëndësi dhe as pa rëndësi, 3% si jo me rëndësi dhe 1% si aspak me rëndësi. 2% nuk e dinin ose refuzuan të përgjigjen.

Figura 25 Sa e rëndësishme është çështja e ndryshimeve klimatike për ju?





Figura 26 tregon vetëm dallime të vogla mes grupmohave. Më shumë se 50% e të anketuarve nga çdo grupmoshë i konsiderojnë ndryshimet klimatike si çështje me rëndësi për ta.




Figura 26 Sa e rëndësishme është çështja e ndryshimeve klimatike për ju? - sipas moshës




Sërish, nuk ka dallime të mëdha mes meshkujve dhe femrave kur bëhet fjalë për vlerësimin e tyre për rëndësinë e ndryshimeve klimatike. 29% e meshkujve dhe 26% e femrave e konsiderojnë çështjen e ndryshimeve klimatike si shumë me rëndësi për ta; 54% e meshkujve dhe 49% e femrave i konsiderojnë me rëndësi ndryshimet klimatike.

Figura 27 Sa e rëndësishme është çështja e ndryshimeve klimatike për ju? - sipas moshës




Nuk ka pabarazi të konsiderueshme mes grupeve etnike tek të anketuarit që thonë se ndryshimet klimatike janë çështje me shumë rëndësi për ta, dhe të gjitha janë midis 20% dhe 30%. Ekziston një pabarazi shumë më domethënëse mes atyre që e konsiderojnë me rëndësi: 53% e pjesëmarrësve shqiptarë, 26% e serbëve dhe 46% e etnive të tjera.

Figura 28 Sa e rëndësishme është çështja e ndryshimeve klimatike për ju? – sipas përkatësisë etnike



Siç tregon figura 29 (më poshtë), kur iu kërkua të identifikonin shqetësimet e tyre kryesore nga një listë e çështjeve mjedisore, të anketuarit kishin më shumë gjasa të zgjidhnin ndotjen e ajrit si më të ngutshmen (26%). Kjo ndiqej nga ndotja e ujërave/ujit të pijshëm dhe lumenjve (18%), hedhja e mbeturinave (11%), menaxhimi i dobët i mbeturinave (8%), përdorimi i automjeteve të vjetra si mjete të transportit (6%), termocentralet (4%), ujërat e zeza (4%), menaxhimi i mbeturinave të ngurta (3%), vërshimet (3%) dhe plastika (3%). 14% zgjedhën të gjitha sa më lart.


Figura 29 Nga kjo listë e çështjeve mjedisore që e prekin Kosovën, cila ju shqetëson më shumë?



Të dhënat e zberthyer sipas moshës nuk e ndryshojnë ndjeshëm hierarkinë e shqetësimeve: të gjitha grupmoshat e konsiderojnë ndotjen e ajrit si kërcënimin më të madh për ta. Pas këtij kërcënimi, tek të moshuarit (> 65) ka prioritete më pak të theksuara të shqetësimeve: vetëm 9% e tyre e shohin ndotjen e ujërave/ujit të pijshëm/lumenjve si shqetësimin e tyre më të madh, krahasuar me rreth 20% e të anketuarve të rinj, të rriturve dhe atyre në moshë të mesme.


Edhe pse ndotja nga plastika njihet në mbarë botën si një shqetësim i madh mjedisor, marrë parasysh ndikimin e saj në cilësinë e ujërave, mirëqenien e kafshëve dhe shëndetin e qytetarëve, të dhënat tona tregojnë se kjo konsiderohet me më pak prioritet në Kosovë bazuar në përgjigjet në këtë anketë. 0% e të anketuarve të moshës 45-54 vjeç dhe vetëm 1% e atyre të moshës 55-64 vjeç e konsiderojnë plastikën si kërcënimin më të madh. Krahasuar me të moshuarit, të rinjtë duken relativisht më të vetëdijshëm dhe të shqetësuar për ndikimin e përdorimit të plastikës në mjedis: 6% e zgjodhën atë. Duhet të theksohet se rreth 14% e pjesëmarrësve nga të gjitha grupmoshat kanë zgjedhur “të gjitha sa më lart” (përfshirë përdorimin e plastikës) si shqetësimin e tyre, por është ende e dukshme indiferenca relative ndaj përdorimit të plastikës.

Figura 30 Nga kjo listë e çështjeve mjedisore që e prekin Kosovën, cila ju shqetëson më shumë? - sipas moshës




Të dhënat e zërthyer sipas gjinisë nuk tregojnë dallime të rëndësishme mes meshkujve dhe femrave në renditjen e shqetësimeve të tyre më të larta mjedisore. Si femrat ashtu edhe meshkujt e renditin ndotjen e ajrit mbi prapun 20%, e ndjekur nga ndotja e ujit (18% e pjesëmarrësve nga të dyja gjinitë).

Figura 31 Nga kjo listë e çështjeve mjedisore që e prekin Kosovën, cila ju shqetëson më shumë? - sipas gjinisë




Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike nxjerrin disa dallime interesante: ndotja e ujërave/ujit të pijshëm/lumenjve konsiderohet si shqetësimi më i madh (30%) për pjesëmarrësit serbë të Kosovës, ndërsa është shqetësimi i dyti për shqiptarët e Kosovës (17%) dhe i treti për të anketuarit nga etnitë e tjera (16%). Për shqiptarët e Kosovës (26%) dhe të anketuarit e etnive të tjera (28%), ndotja e ajrit mbetet shqetësimi kryesor, por vetëm 17% e pjesëmarrësve serbë pajtohen me këtë. Kjo mund të lidhet me dallimet në cilësinë e infrastrukturës së ujit të pijshëm ndërmjet komunave me përqindje më të lartë të një grupi etnik ndaj tjetrit. Komunitet me shumicë serbe dhe kompanitë përkatëse rajonale të ujësjellësit kanë më pak koordinim me institucionet qendrore për qasjen në fonde për të përmirësuar infrastrukturën e tyre të ujit të pijshëm.

Figura 32 Nga kjo listë e çështjeve mjedisore që e prekin Kosovën, cila ju shqetëson më shumë? - sipas përkatësisë etnike



Të anketuarve iu kërkua gjithashtu të ndajnë opinionet e tyre për mënyrat për të reduktuar efektet negative të ndryshimeve klimatike. Menaxhimi më i mirë i mbeturinave (18%) dhe përdorimi i energjisë së ripërtërishme (18%) kishin përqindjet më të larta. Renditja e opsioneve të tjera për të zbutur ndryshimet klimatike ishte: teknologjitë e reja të gjelbra (16%), ekonomia qarkore (13%), riciklimi (13%), pajisjet me efikasitet të energjisë (9%), vetëdijesimi i publikut (8%), reduktimi i emetimeve të gazrave serë (3%) dhe më pas të tjerat (3%).


Figura 33 Çka mendoni se mund të ndihmojë për zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike?



Teksa 31% e të moshuarve (>65) mendonin se menaxhimi më i mirë i mbeturinave ishte zbutja më e mirë e ndryshimeve klimatike, vetëm 11% e të rinjve (18-24) u pajtuan me këtë. Energjia e ripërtërishme, e renditur e dyta në përgjithësi, u mbështet në mënyrë më të barabartë nga pjesëmarrësit në të gjitha grupmoshat. Teksa sektori i mbeturinave kontribuon në emetimet e GS-ve, djegia e derivateve fosile kontribuon më shumë. Megjithatë, duke qenë se shumica e pjesëmarrësve zgjedhën “menaxhimin e mbeturinave”, “hedhjen e mbeturinave”,


“menaxhimin e mbeturinave të ngurta” dhe “ndotjen plastike” si çështjen mjedisore që i shqetëson më shumë, ka kuptim që ata zgjedhën “menaxhimin më të mirë të mbeturinave” si masa më e mirë për zbutjen e ndryshimeve klimatike. Kjo përkundër faktit se menaxhimi më i mirë i mbeturinave kontribuon në mënyrë të papërfillshme në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Kjo vërteton dy supozime kryesore: 1) publiku nuk është në dijeni të shkaqeve të ndryshimeve klimatike dhe GS-ve; dhe 2) publiku është i shqetësuar për një çështje mjedisore që është më e prekshme për jetën e tyre të përditshme, duke parë mjedisin e tyre të ndotur nga mbeturinat e ngurta.

Figura 34 Çka mendoni se mund të ndihmojë për zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike? - sipas moshës




Të dhënat e zbrërthyer sipas gjinisë tregojnë se energjia e ripërtërishme u rendit nga meshkujt (19%) si zgjidhja e parë për të luftuar efektet negative të ndryshimeve klimatike dhe pak më ulët nga femrat (16%). Si femrat (19%) ashtu dhe meshkujt (17%) mbështesin menaxhimin më të mirë të mbeturinave.

Figura 35 Çka mendoni se mund të ndihmojë për zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike? - sipas gjinisë



Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se të anketuarit e etnive të tjera ishin dukshëm më të impresionuar (47%) nga menaxhimi më i mirë i mbeturinave si mjet për zbutjen e efekteve negative të ndryshimeve klimatike, krahasuar me serbët (19%) dhe shqiptarët (17%). 30% e serbëve janë më të impresionuar nga teknologjitë e gjelbra, me shqiptarët dhe të anketuarit e etnive të tjera më pak të impresionuar (të dy 16%). Shqiptarët e renditën energjinë e ripërtërishme (18%) si zgjidhjen kryesore për të zbutur ndryshimet klimatike, ndërsa serbët (16%) dhe etnitë e tjera (11%) ishin më pak optimistë për këtë.


Figura 36 Çka mendoni se mund të ndihmojë për zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike? - sipas përkatësisë etnike



### Opinionet rreth financimit prej institucioneve qendrore për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe për inkurajimin e dekarbonizimit.


Figura 37, më poshtë, tregon se një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve (70%) do ta mbështesin financimin institucional për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve klimatike në popullatën e Kosovës. Vlen të përmendet që 28% pohuan se nuk do ta mbështesnin një financim të tillë, dhe 1% nuk e dinin.

Figura 37 A do të mbështesnit financimin institucional (taksat që paguani ju) për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve klimatike, si ndotja e ajrit, tek popullsia e Kosovës?




Hulumtimi nuk tregon ndonjë dallim domethënës mes grupmohave në mbështetjen e financimit institucional për të vlerësuar ndikimet e ndryshimeve klimatike. Rreth 70% e të anketuarve nga çdo grupmoshë mendojnë se do ta mbështesnin një vlerësim të tillë.

Figura 38 A do të mbështesnit financimin institucional (taksat që paguani ju) për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve klimatike, si ndotja e ajrit, tek popullsia e Kosovës? - sipas moshës



Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se meshkujt (75%) janë më të gatshëm ta mbështesnin financimin institucional për vlerësimin e ndikimit të ndryshimeve klimatike në popullatën e Kosovës, ndërsa femrat janë më pak të gatshme (65%). Megjithatë, një shumicë e qartë e meshkujve dhe femrave deklaruan se do ta mbështesnin një veprim të tillë institucional.


Figura 39 A do të mbështesnit financimin institucional (taksat që paguani ju) për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve klimatike, si ndotja e ajrit, tek popullsia e Kosovës? - sipas gjinisë






Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve shqiptarë (72%) do ta mbështesin financimin institucional për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë. Të anketuarit e etnive të tjera (54%) dhe serbët (44%) ishin relativisht më pak të gatshëm.

Figura 40 A do të mbështesnit financimin institucional (taksat që paguani ju) për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve klimatike, si ndotja e ajrit, tek popullsia e Kosovës? - sipas përkatësisë etnike




Pjesëmarrësve iu kërkua gjithashtu të ndajnë mendimet e tyre në lidhje me shqiptimin e gjobave për hedhjen e mbeturinave dhe për vendosjen e një tarife për qeset plastike. Sërish, një shumicë e qartë (77%) treguan se do t'i mbështesnin iniciativa të tilla, ndërsa 22% pohuan se nuk do t'i mbështesnin. Edhe pse, si më lart, të anketuarit në përgjithësi nuk e renditën ndotjen plastike si problemin kryesor, gatishmëria për të mbështetur një përgjigje të tillë nga institucionet qendrore sugjeron njohjen e ndikimit të ndotjes plastike në mjedis.

Figure 41 A do t'i mbështesnit institucionet qendrore/komunën nëse do të shqiptonin gjoba për hedhje të mbeturinave dhe qeseve plastike?




Të moshuarit (>65) shprehën nivelin më të lartë të mbështetjes për këtë çështje (82%), të ndjekur nga të rriturit në grupin 35-44 (79%). Mbështetja e të rinjve për masat kundër hedhjes së mbeturinave dhe qeseve plastike ishte relativisht më e dobët (74%), por gjithsesi shumë e konsiderueshme dhe jo shumë e ndryshme nga më të rriturit dhe të moshuarit.

Figure 42 A do t'i mbështesnit institucionet qendrore/komunën nëse do të shqiptonin gjoba për hedhje të mbeturinave dhe qeseve plastike? - sipas moshës




Meshkujt ishin më mbështetës (81%) sesa femrat (73%).

Figure 43 A do t'i mbështesnit institucionet qendrore/komunën nëse do të shqiptonin gjoba për hedhje të mbeturinave dhe qeseve plastike? - sipas gjinisë



Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se shqiptarët kanë gatishmërinë më të madhe (78%) që t'i mbështesin institucionet qendrore dhe komunat për shqiptimin e gjobave për hedhjen e mbeturinave dhe për tarifat për qeset plastike. Shumica dërrmuese (69%) e të anketuarve nga etnitë e tjera gjithashtu shprehën mbështetje. Edhe pse përkrahës në fund të fundit, të anketuarit serbë ishin relativisht më të kujdesshëm (54%).

Figure 44 A do t'i mbështesnit institucionet qendrore/komunën nëse do të shqiptonin gjoba për hedhje të mbeturinave dhe qeseve plastike? - sipas përkatësisë etnike



Në anketën e opinionit të kryer në prill 2022, të anketuarit u pyetën gjithashtu nëse do të ishin të gatshëm të paguanin tarifa më të larta të energjisë elektrike për hir të minimizimit të ndikimeve të ndryshimeve klimatike tek gjeneratat e ardhshme. 31% e të anketuarve deklaruan se do të ishin të gatshëm të paguanin tarifa më të larta, ndërsa 65% jo, dhe 4% të mbetur ose refuzuan të përgjigjen ose nuk e dinin.

Figura 45 A jeni të gatshëm të paguani tarifa më të larta për energjinë elektrike për hir të minimizimit të ndikimit të ndryshimeve klimatike tek gjeneratat e ardhshme?






Figura 46 (më poshtë) ilustron se pjesëmarrësit e të gjitha grupmoshave shprehën nivele të ngjashme të gatishmërisë për të paguar fatura më të larta të energjisë elektrike. Të rinjtë (18-24) ishin relativisht më të gatshëm (34%), krahasuar me të anketuarit e moshës 55-64 vjeç dhe të moshuarit (>65) – të dy 28%. Do të ishte interesante të vlerësohej e njëjta pyetje tani me vendimet e reja për tarifën për shkak të ndikimit të krizës energjetike në Evropë. Në analizën e radhës, do të ishte informative të shihej se sa pjesëmarrës votojnë në favor të një kategorie të caktuar të rritjes së tarifave siç propozohet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Në realitet, ndryshimet aktuale të tarifave po pasqyrojnë vetëm ndikimin e faktorëve ekzogjenë në tregun e importit të energjisë dhe nuk janë domosdoshmërisht të lidhura me minimizimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Nëse tarifën e reja mbeten në përputhje me stimujt për konsumatorët e energjisë së pastër siç është politika e njehsimit neto, atëherë tarifën më të larta të energjisë elektrike kontribuojnë në minimizimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Në mënyrë të ngjashme, nëse tarifën më të larta lidhen me një rrjedhë shtesë të ardhurash për financimin e projekteve të energjisë së ripërtërishme, rritjen e kapacitetit të rrjetit për burimet e ripërtërishme ose projekte të tjera që ulin emetimet e GS-ve, atëherë politikëbërësit mund ta përdorin këtë gjetje për t'u siguruar se publiku në përgjithësi e mbështet një mekanizëm të tillë.

Figura 46 A jeni të gatshëm të paguani tarifa më të larta për energjinë elektrike për hir të minimizimit të ndikimit të ndryshimeve klimatike tek gjeneratat e ardhshme? - sipas moshës




Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë tregojnë disa ndryshime në këtë pyetje. 35% e meshkujve deklaruan se do të ishin të gatshëm të paguanin tarifa më të larta, krahasuar me 26% të femrave.

Figura 47 A jeni të gatshëm të paguani tarifa më të larta për energjinë elektrike për hir të minimizimit të ndikimit të ndryshimeve klimatike tek gjeneratat e ardhshme? - sipas gjinisë



Për fundi, të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se shqiptarët (31%) dhe anketuarit e etnive të tjera (30%) duket se janë më të gatshëm të paguajnë tarifa më të larta të energjisë elektrike në krahasim me të anketuarit serbë (17%).

Figura 48 A jeni të gatshëm të paguani tarifa më të larta për energjinë elektrike për hir të minimizimit të ndikimit të ndryshimeve klimatike tek gjeneratat e ardhshme? - sipas përkatësisë etnike



## Gjetjet nga diskutimet në grupe të fokusit

Shtatë diskutime në grupe të fokusit u zhvilluan gjatë prillit dhe majit 2022, për të marrë informacion dhe perceptime të thelluara nga grupe të ndryshme të palëve të interesit mbi

ndryshimet klimatike dhe gjurmën e karbonit në Kosovë. Palët e interesit përfshinin përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale të përfshira drejtpërdrejt në fushën e ndryshimeve klimatike, OJQ lokale dhe nacionale që punojnë në terren, biznese të vetëshpallura të gjelbra, kompani prodhuese dhe kompani të tjera të lidhura me shërbimet.

Të gjitha diskutimet filluan me një raund prezantimesh për t'i bërë pjesëmarrësit të ndihën komodë dhe të njohur me temën. Temat u ndanë në katër seksione: 1) perceptimet e përgjithshme të ndryshimeve klimatike dhe gjurmës së karbonit në Kosovë; 2) Sfidat dhe përgjigjet e Kosovës ndaj ndryshimeve klimatike dhe gjurmës së karbonit; 3) vetëdijesimi i palëve të interesit për përpjekjet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare për ndryshimet klimatike dhe dekarbonizimin; 4) rruga përpara. Për secilin seksion u krye analiza ndërmjet palëve të interesit dhe gjetjet u ndanë në mënyrë tematike.

## I. Perceptimet e përgjithshme të ndryshimeve klimatike dhe gjurmës së karbonit në Kosovë

Pjesëmarrësit duket se kanë perceptime dhe besime të ngjashme rreth ndikimit të ndryshimeve klimatike dhe gjurmës së karbonit në Kosovë. Perceptimet e tyre ndryshonin vetëm për sa i përket renditjes së ndotësve kryesorë dhe zgjidhjeve. Të gjithë kanë dëgjuar për ndryshimet klimatike dhe janë të vetëdijshëm për ndikimet e tyre negative, dhe për sfidat e Kosovës në lëvizjen drejt një të ardhmeje më të gjelbër me më pak efekte të ndryshimeve klimatike.

Të gjitha palët e interesit ishin në dijeni të dokumenteve dhe strategjive të politikave të Kosovës për ndryshimet klimatike dhe gjurmën e karbonit, siç është Strategjia për Ndryshimet Klimatike (2019-2028).<sup>14</sup> Atyre iu dha informacion i përmbledhur në lidhje me dokumentet e tjera të politikave.

Të gjitha palët e interesit ishin konsistente në pohimin se këto strategji nuk janë zbatuar plotësisht. Edhe përfaqësuesit e nivelit qendror konsiderojnë se duhet bërë më shumë në këtë drejtim. OJQ-të shprehën shqetësimin e tyre për progresin e ngadaltë të Kosovës drejt respektimit të marrëveshjeve ndërkombëtare. Për shembull, ata përmendën se si Kosova është e detyruar sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të arrijë dekarbonizimin deri në vitin 2050<sup>15</sup>. Ata mendojnë se Kosova mund të izohet lehtë nga Bashkimi Evropian (BE) nëse dështon t'u përmbahet standardeve të BE-së dhe nuk respekton zotimet e veta. OJQ-të besojnë se Kosovës i mungojnë politikat dhe stimujt e duhur të gjelbër për individët dhe bizneset që të veprojnë kundër ndryshimeve klimatike dhe sfidave të dekarbonizimit. Pjesëmarrësit nga niveli qendror thanë se ndikimet socio-ekonomike të COVID-19 ishin bërë

---

<sup>14</sup> Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019- 2028, Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike 2019- 2021, marrë nga: <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=29356>

<sup>15</sup> Ju lutemi vini re se Kosova është zyrtarisht e përkushtuar për të arritur një kontinent neutral ndaj karbonit (Evropa) deri në vitin 2050 përmes Deklaratës së Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Komisioni Evropian, 2020, Samiti i Ballkanit Perëndimor në Sofje: Hidhen hapa të rëndësishëm drejt avancimit të bashkëpunimit rajonal për të nxitur rimëkëmbjen socio-ekonomike dhe konvergencën me BE-në, marrë nga: [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip\\_20\\_2051](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_20_2051)

pengesë që ndryshimet klimatike të trajtoheshin si çështje urgjente. Një pjesëmarrës nga një OJQ tha se ndotja e ajrit dhe ndryshimet klimatike kanë qenë gjithmonë një problem:

**“Arsyeja pse nuk i morëm seriozisht [ndryshimet klimatike] është thjesht se për më shumë se 22 vjet ne jemi marrë me çështje të tjera si shoqëri, si politika, zhvillimi socio-ekonomik dhe punësimi”.**

Institucionet qendrore i shohin emetimet e gazrave serë si një nga ndotësit kyç të mjedisit. Ata e gjykojnë me rëndësi që të fokusohen në dekarbonizimin e sektorit energjetik dhe mënyrat si mund të zvogëlohet varësia e tij nga lëndët djegëse fosile dhe të rritjet përdorimi i burimeve alternative të energjisë si burimet e ripërtërishme. Ujërat e zeza të patrajuara, silkapori, pluhuri i aluminit, deponitë, mbeturinat e kafshëve shtëpiake dhe mbeturinat mjekësore u renditën gjithashtu si ndotësit kryesorë të mjedisit. Pjesëmarrësit nga institucionet qendrore përmendën më tej industrinë e prodhimit si një tjetër ndotës kyç për shkak të mbetjeve të tepërta dhe rrjedhjeve. Bizneset e shërbimeve treguan se disa kompani prodhuese nuk kanë mekanizma filtrues. Është e rëndësishme të theksohet këtu se as institucionet qendrore dhe as kompanitë prodhuese nuk janë në dijeni të gazrave të dëmshëm që lëshojnë. Nga ana tjetër, kompanitë prodhuese konsiderojnë përdorimin e thëngjillit dhe sektorin e ndërtimit si ndotësit më të mëdhenj. Përfaqësuesit e autoriteteve komunale pajtohen se fabrikat janë ndër ndotësit kyç, pa specifikuar llojin e industrisë. Ata përmendën se edhe mungesa e transportit publik dhe përdorimi i autobusëve të vjetër për transport publik shkakton dëm të konsiderueshëm në mjedis. Komunitatet propozuan hartimin e një strategjie komunale për Qytete të Mençura për të ofruar transport alternativ ndaj automjeteve me derivat konvencional.

Të gjitha palët e interesit, përfshirë komunitetin e biznesit, përmendën mungesën e vetëdijesimit publik. Të gjitha palët e interesit besojnë se duhet bërë më shumë për edukimin e popullatës, veçanërisht të rinjve. Pjesëmarrësit prej OJQ-ve besojnë se përveç vetëdijesimit të ulët të publikut, mungon edhe vetëdijesimi institucional.

Për fundi, pjesëmarrësit prej OJQ-ve pranuan se kishte pasur njëfarë progresi në këtë sektor. Ata theksuan se janë ndërmarrë hapa për trajtimin e duhur të ujërave të zeza, veçanërisht në komunitatet e Ferizajt dhe Mitrovicës. Por ata e pranojnë se Kosova është shumë prapa vendeve të tjera.

## **II. Sfidat dhe përgjigjet e Kosovës ndaj ndryshimeve klimatike dhe gjurmës së karbonit**

Pjesëmarrësve iu kërkua gjithashtu të përshkruanin sfidat e Kosovës në lidhje me ndryshimet klimatike dhe gjurmën e karbonit, si dhe përgjigjet për trajtimin e tyre. Kjo ishte një mundësi për të diskutuar masat që ata vetë kanë marrë si institucione, shoqëri civile, apo biznese.

Pjesëmarrësit nga institucionet qendrore theksuan sfidat që rrjedhin nga menaxhimi i dobët i mbeturinave, ku ende nuk ka një sistem publik riciklimi. Ka nisma informale, të organizuara nga individë dhe kompani, por nuk ka një sistem kombëtar për të organizuar të gjithë procesin e riciklimit. Pjesëmarrësit nga institucionet qendrore theksuan se Kosova është në proces të

zhvillimit të programit të riciklimit për rimbursimin e shisheve plastike të grumbulluara, dhe njëkohësisht është në proces të ngritjes së disa qendrave ku mbeturinat do të përpunohen dhe riciklohen sipas llojit. Më tej ata deklaruan se ka shumë fusha ku institucionet publike të Kosovës kanë bërë progres në luftimin e efekteve negative të ndryshimeve klimatike dhe përshejtimin e procesit të dekarbonizimit. Për shembull, ata theksuan se një nga objektivat e Strategjisë për Ndryshimet Klimatike ishte përgatitja e inventarit të gazrave serë, çka tashmë është duke e bërë Ekipi për GS-të i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK).

Një përfaqësues i institucioneve qendrore iu referua një sfide shtesë në sektorin privat:

**“Sfidë e madhe për ministrinë tonë është keqpërdorimi i subvencioneve nga bizneset. Ne kemi subvencionuar shumë biznese me panele solare. Megjithatë, kur i vizitua, zbuluam se ato nuk ishin përdorur kurrë, duke ngritur pyetje në lidhje me qëllimin dhe përdorimin e atyre paneleve solare.”**

Përfaqësuesit e institucioneve qendrore përshkruan se si po reagojnë ndaj ndryshimeve klimatike. Ata deklaruan se institucionet e tyre po punojnë për rregulloret e shumta ligjore që lidhen me ndryshimet klimatike, dekarbonizimin dhe emetimet e gazrave serë. Mes tyre është një strategji afatgjatë e dekarbonizimit, e cila do të jetë një gur themeli për adresimin e këtyre çështjeve. Ministritë e linjës kanë punuar gjithashtu për Strategjinë Kombëtare të Energjisë (2022-2031), e cila është përmendur disa herë si një dokument kyç, por ende nuk është miratuar. Një Këshill Ndërmintoror për Ndryshimet Klimatike u krijua më 21 gusht 2015, për të shërbyer si një mekanizëm koordinues për të gjitha aktivitetet për ndryshimet klimatike. Megjithatë, për shkak të ndryshimeve të shpeshta në lidhje me liderimin politik, puna e këshillit nuk ka qenë vazhdimisht e rregullt. Këshilli tashmë është plotësisht funksional dhe sekretariati i tij teknik ka filluar punën me mbështetjen e UNDP-së.

Përfaqësuesit e autoriteteve lokale ishin të mendimit se Kosova ka bërë progres në luftimin e efekteve të ndryshimeve klimatike. Njëri vuri në pah ngritjen e një fabrike në Bukosh që ndan mbeturinat, me një investim prej tre milionë dollarësh. Më parë komunave u mungonte një kod financiar dhe një plan për menaxhimin e mbeturinave; tani, sipas tyre, komunat i kanë të dyja.

Megjithatë, autoritetet lokale përmendën sfida të ngjashme me ato të autoriteteve qendrore: ndotja nga termocentralet; leje ndërtimi të pakontrolluara; mbetjet industriale nga vendet si Mitrovica, Obiliqi, Hani i Elezit dhe Drenasi (me Ferronikelin si një nga ndotësit më të mëdhenj); dhe menaxhimi i dobët i pyjeve të cilat po shkatërrohen përmes shfrytëzimit të pakontrolluar dhe mbrojtjes joadekuate institucionale. Ata gjithashtu kërkuan më shumë kompetenca dhe mbështetje nga institucionet qendrore për të zhvilluar aktivitete që synojnë luftimin e ndryshimeve klimatike. Disa përfaqësues të autoriteteve lokale ndanë gjithashtu detaje të hapave të ndërmarrë në nivel komunal për të frenuar ndryshimet klimatike dhe për të bërë përpjekje për dekarbonizim. Për shembull, një përfaqësues i Komunës së Lipjanit pohoi:

**“Në Lipjan kemi ndërmarrë disa hapa pozitivë për t’i zbutur efektet e ndryshimeve klimatike. Aktualisht jemi duke zhvilluar një projekt për**

**riciklimin e mbeturinave; ka më shumë sipërfaqe të gjelbra dhe parqe sesa në të kaluarën, dhe po hartohet një plan veprimi lokal mjedisor. Sfida më e madhe për komunën tonë është se Lipjani është shumë i rrafshët dhe kjo rrit interesimin e investorëve për ndërtimin e objekteve të ndryshme, si për qëllime banesore ashtu edhe komerciale, çka ndikon negativisht në mjedis.”**

Ndryshe nga institucionet qendrore dhe lokale, përfaqësuesit e bizneseve të gjelbra besojnë se nuk është bërë shumë në drejtim të dekarbonizimit, pastrimit të lumenjve dhe qasjes në ujë të pijshëm të sigurt. Ata besojnë se shumë liqene dhe lumenj po dëmtohen edhe më shumë, dhe se rruga drejt dekarbonizimit fillon me mbrojtjen e liqeneve dhe lumenjve në nivel të gjithë Kosovës. Termocentralet me thëngjill u përmendën gjithashtu si një nga ndotësit më të mëdhenj dhe u sugjerua që të punohet drejt politikave që reduktojnë dëmet e shkaktuara nga termocentralet duke kaluar pa probleme në energjitë alternative. Një pjesëmarrës ngriti një pikë tjetër specifike shqetësuese:

**Autolarjet në Kosovë nuk kanë gropa që filtrojnë ujin, që nga ana tjetër është jashtëzakonisht e dëmshme sepse produktet e pastrimit janë acide dhe e dëmtojnë shumë mjedisin.**

Bizneset e gjelbra që merrnin pjesë në diskutimet e grupeve të fokusit dukeshin shumë të vetëdijshëm për mjedisin dhe të sigurt se po luajnë rolin e tyre në dekarbonizimin dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Praktikat e tyre përfshijnë përdorimin e materialeve të riciklueshme për të gjitha dokumentet dhe materialet e printuara dhe zëvendësimin e dritave inkandeshente ose halogjene me pajisje LED që shërbejnë si ngrohës gjatë dimrit dhe klimatizues gjatë verës. Një tjetër pjesëmarrës ndau në detaje praktikat e qëndrueshme të biznesit që po aplikon kompania e tyre:

**“Ka një nivel të lartë të kontaminimit të kryqëzuar në spitale, të cilët janë ndotësit më të mëdhenj, sepse nuk zbatojnë kontrollin e cilësisë sipas standardeve. Si rezultat, të gjitha dhomat e spitalit janë të kontaminuara, dhe bakteret përhapen lehtësisht. Prandaj, ne përdorim sterilizimin me avull për veglat dhe pajisjet mjekësore, duke përfshirë barnat, lëngjet, instrumentet kirurgjikale, kontejnerët metalikë, të implantueshme dhe të ripërdorshme, të cilat janë 90-100% të riciklueshme, dhe synojmë t’i standardizojnë shërbimet higjienike në spitale”.**

Një biznes tjetër ndërton nënstacione që ndihmojnë parqet e energjisë solare për të shpërndarë energjinë në të gjithë rrjetin, ndërkohë që të gjitha mbetjet riciklohen ose ripërdoren për të minimizuar ndotjen. Ato nënstacione kanë dukshëm më pak zhurmë dhe ndihmojnë në mbrojtjen e mjedisit. Një tjetër pjesëmarrës nga një biznes i gjelbër shpjegoi se si po i frenojnë efektet e ndryshimeve klimatike:



## **“Panelet solare do të vendosen në objektet tona dhe do të përfundohen këtë vit. Si biznes i gjelbër, ne kemi filtra të duhur për pluhurin dhe zhurmën, duke e mbrojtur mjedisin”.**

Një tjetër kompani e gjelbër deklaroi se po punojnë për kalimin në makina elektrike; ata tashmë kanë mbushës të automjeteve elektrike. Ata besojnë se automjetet me naftë nuk do të ekzistojnë më pas 5-10 vjetësh. Bateritë në makinat elektrike janë gjithashtu të riciklueshme. Megjithatë, ata pranojnë se puna drejt dekarbonizimit do të jetë e vështirë sepse shërbimet që ata ofrojnë përfshijnë kamionë dhe ekskavatorë, të cilët janë ndotës të mëdhenj.

Bizneset në sektorë të tjerë janë gjithashtu të vetëdijshëm për efektet e ndryshimeve klimatike. Ata përmendën ndryshimet e shpeshta të temperaturës dhe prishjen e ekuilibrit të reshjeve si pasojë e ndryshimeve klimatike. Ata përmendën se si ndryshimet klimatike dhe ndotja e ajrit kanë rritur incidencën e sëmundjeve të frymëmarrjes dhe kardiovaskulare. Pjesëmarrësit shprehën besimin e tyre se në qytetet me ndotje të madhe të ajrit, rreth 90% e fëmijëve kanë probleme me frymëmarrjen.

Një nga praktikat negative që ndikon në ndryshimet klimatike në afat të gjatë është edhe përdorimi i tokës bujqësore për ndërtim. Djegia e thëngjillit për prodhimin e energjisë shihet si ndotësi më i rëndësishëm, por shpyllëzimi është gjithashtu një çështje serioze, me rreth një hektar pyll në ditë që humbet për shkak të prerjeve të paligjshme, sipas pjesëmarrësve. Një pjesëmarrës ngriti sfidën e therjes së kafshëve për shkak të mungesës së një deponie për kafshët e therura.

Bizneset ishin gjithashtu të vetëdijshme se, nëpërmjet konsumit të tyre të energjisë dhe materialeve, ato e ndotin mjedisin dukshëm më shumë se familjet.

Pjesëmarrësve nga sektori privat iu kërkua të ndajnë mendimet e tyre se si bizneset e tyre ndikojnë në mjedis dhe nëse po ndërmerren veprime për t'i zbutur ato efekte. Njëri prej tyre pohoi se edhe pse përpiqen ta shmangin përdorimin e qeseve të pariciklueshme, ata sërish e dëmtojnë mjedisin në mënyra të tjera, si p.sh. prodhimi i produkteve që përmbajnë kimikate të dëmshme për mjedisin. Një përfaqësues i një kompanie farmaceutike tha se industria e tyre e dëmton mjedisin duke përdorur qese plastike dhe duke mos i asgjësuar siç duhet medikamentet e skaduara.

Ndërkohë OJQ-të konsiderojnë se termocentralet dhe guroret janë ndër ndotësit më të mëdhenj. Një problem shtesë është se Kosova nuk ka burime të mjaftueshme për të përdorur burime alternative të energjisë. Kosova ka mungesë të burimeve ujore dhe të energjisë së erës. Ata pohuan se ndonëse guroret e licencuara janë të detyruara me ligj ta kthejnë vendin ku punojnë në gjendjen e mëparshme, asnjë kompani nuk e bën këtë. Ata përmendën gjithashtu efektet negative të mbetjeve të ngurta, si betoni dhe emetimet e automjeteve motorike.

Pjesëmarrësit nga OJQ-të në përgjithësi mendojnë se kanë bërë shumë për frenimin e efekteve të ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit. Një përfaqësues i një OJQ-je ndau një shembull specifik:

**“Pa ne, termocentrali Kosova e Re nuk do të ishte ndalur. Ne kemi kontribuar shumë edhe në hartimin e Ligjit për Energjinë e Ripërtërishme, i cili ende nuk është votuar në Kuvend”.**

### **III. Vetëdijesimi i palëve të interesit për përpjekjet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare për ndryshimet klimatike dhe dekarbonizimin**

Në përgjithësi, pjesëmarrësit në të gjitha diskutimet në grupe të fokusit kishin informacion rreth përpjekjeve në mbarë Kosovën dhe ato ndërkombëtare për ndryshimet klimatike dhe dekarbonizimin. Rajoni i Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, do të zbatojë Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor – një strategji për rritje që ndjek Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe synon të përshpejtojë kalimin nga një model ekonomik tradicional në një ekonomi të qëndrueshme. U përmend edhe Traktati për Komunitetin e Energjisë, një iniciativë tjetër e BE-së e cila i jep Kosovës disa obligime lidhur me energjinë. Pjesëmarrësit nga institucionet qendrore kishin njohuri të kufizuara për obligimet e Kosovës që dalin nga këto marrëveshje. Një pjesëmarrës nga institucionet lokale iu referua disa marrëveshjeve ndërkombëtare për të përmirësuar qëndrimin kundrejt ndryshimeve klimatike, duke përfshirë objektivin afatgjatë për të mos lejuar rritjen e temperaturës globale për më shumë se 1.5 gradë Celsius. Ata ishin të vetëdijshëm se ka objektiva të caktuara që duhet të arrihen, veçanërisht në lidhje me termocentralet. Ata pohuan se ka nevojë për investime në sektorin energjetik (investime në termocentralet të reja), sepse kur rritet eficientia ulet kërkesa për prodhim.

Një përfaqësues i institucioneve qendrore beson se Kosova ka krijuar një mjedis të favorshëm biznesi për investitorët, dhe kështu bizneset – si ato për prodhim dhe përpunim – po investojnë pa kujdes dhe pa pasur nevojë të respektojnë standardet mjedisore, dhe të gjitha këto ndikojnë negativisht në mjedis.

### **IV. Cila është rruga përpara?**

Grupet e interesit ishin të vetëdijshëm për sfidat e Kosovës dhe se sa është e kërcënuar nga ndryshimet klimatike. Ata ishin gjithashtu të vetëdijshëm për rolet dhe përgjegjësitë e tyre në këtë fushë. Ata besojnë se vetëm me përpjekje të përbashkëta mund të arrihen zgjidhje reale. Fushatat e vetëdijesimit për ndryshimet klimatike me qëllim të ndryshimit të sjelljes janë një metodë vendimtare për zbutjen e riskut të ndryshimeve klimatike.

Institucionet qendrore besojnë se një fushë e fokusit në të ardhmen e afërt është rritja e vetëdijesimit të publikut për eficientcën e energjisë. Ata besojnë se nevojiten më shumë fushata vetëdijesimi, duke përfshirë nxënësit dhe familjet. Një shembull për këtë ishin fushatat e vetëdijesimit në shkolla për edukimin e nxënësve për ndryshimet klimatike të zbatuara në dekadën e mëparshme. Kjo është edhe më e rëndësishme duke pasur parasysh

se ka ende qytetarë, përfshirë edhe në botën akademike, që e mohojnë ekzistencën e kërcënimit të ndryshimeve klimatike. Zyrtarë të institucioneve qendrore ishin të mendimit se mësimet për ndryshimet klimatike duhet të integrohen në kurrikulë, si lëndë të detyrueshme ose zgjedhore.

Bizneset nga sektorë të ndryshëm sugjeruan gjithashtu më shumë fushata vetëdijesimi. Bizneset e gjelbra sugjeruan që komunat të punësojnë ekspertë për të organizuar fushata vetëdijesimi, sepse bizneset nuk mund të bëjnë ndryshime drastike pa koordinim dhe mobilizim me institucionet. Për sa i përket veprimeve konkrete për parandalimin e ndotjes së mjedisit dhe frenimin e ndryshimeve klimatike, deri tani, përpjekjet institucionale janë të kufizuara në monitorim dhe raportim. Për shembull, një përfaqësues i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës beson se ata kanë kontribuar në rritjen e vetëdijesimit publik për cilësinë e ajrit dhe ujërave duke i monitoruar vazhdimisht dhe duke raportuar për to. Ata gjithashtu përmendën se si kanë vendosur ekrane të monitorit në Prishtinë, duke i dhënë publikut informacion në kohë reale për cilësinë e ajrit. Një pjesëmarrës tjetër mendoi se fushatat e vetëdijesimit nuk çojnë në ndryshime të mëdha; në vend të kësaj ai sugjeroi subvencione për individët dhe bizneset si e vetmja mënyrë për të krijuar ndikim.

Pavarësisht vetëdijesimit më të madh se në të kaluarën për mbrojtjen e mjedisit, institucionet duhet të marrin masa më drastike për të parandaluar ndotjen e mjedisit dhe njëkohësisht për të rritur vetëdijesimin për mbrojtjen e mjedisit. Siç pohoi një pjesëmarrës:

**“Ne mendojmë se policia duhet të jetë më serioze në shqiptimin e gjobave për personat që hedhin mbeturina në vende që nuk duhet ta bëjnë; Policia nuk duhet të presë që inspektorati të shqiptojë gjobë, sepse e ka kompetencën ta bëjë këtë”.**

Institucionet qendrore më tej theksuan se Kosova ka nevojë për mbështetje dhe ndihmë të veçantë nga organizatat ndërkombëtare në fushën e energjisë. Ata shprehën shqetësimin për ndikimin e lëndëve djegëse fosile dhe mënyrën e kalimit në burimet e ripërtërishme të energjisë. Ata kërkuan gjithashtu më shumë investime dhe më shumë vëmendje për energjinë solare dhe hidrike. Një tjetër pjesëmarrës sugjeroi që bashkëpunimi me komunitetin e biznesit për këtë çështje duhet të kthehet në normë, sepse interesi i bizneseve u rrit kur Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit filloi t’i mbështesë.

Kërkohet buxhet i shtuar për financimin e aktiviteteve të parapara në legjislacionin dhe dokumentet e politikave, në mënyrë që Kosova t’i arrijë objektivat e përcaktuara në legjislacion dhe në dokumentet e politikave, si dhe objektivat e përcaktuara nga BE-ja në Marrëveshjen e Gjelbër; kapacitetet njerëzore (njohuritë, shkathtësitë, përvoja) janë një pjesë tjetër që kërkon vëmendje institucionale.

Përfaqësuesit e bizneseve të gjelbra besojnë se rruga përpara është në drejtim tjetër. Ata rekomanduan vizita studimore, shkëmbim njohurish dhe punëtori për shkathtësi me biznese nga vende të tjera në Evropë. Megjithatë, liria e lëvizjes (kufizimet e vizave) u përmend si pengesë. Ata gjithashtu mendojnë se secila komunë duhet që në të ardhmen e afërt të ketë

një ekspert të energjisë së ripërtërishme për t'i trajtuar më mirë sfidat dhe për të ofruar zgjidhje. Përfaqësuesit e bizneseve të gjelbra sugjerojnë kryerjen e një vlerësimi të nevojave për komunat, duke çuar në instalimin e paneleve fotovoltaike ose pompave të nxehtësisë. Një nga pjesëmarrësit nga ky grup ndau rekomandime të mëtejshme se si të kursehet energjia:

**“Të gjithë e dimë se sa ujë sanitar i duhet Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe ata ende përdorin kaldaja për ta ngrohur ujin. Përveç paneleve fotovoltaike, në çdo klinikë mund të vendosen edhe panele termike për ngrohjen e ujit. Gjithashtu, mendoj se në Kosovë duhet të ndalohen kaldajat elektrike, ose të vendosen taksa të larta që të mos jenë lehtësisht të përballueshme. Ne e dimë se këto kanë pasur ndikim të madh në krizën e fundit energjetike. Prandaj, sugjerojmë përdorimin e pompave të nxehtësisë: krahasuar me kaldaja që konsumojnë deri në 22-23 kWh, pompat e nxehtësisë konsumojnë 3-4 kWh”.**

Një pjesëmarrës nga një OJQ tha se shumica e thëngjillit mund të përdoret në bujqësi si pleh organik. Ai gjithashtu përshkroi një projekt që është duke u zhvilluar:

**“Janë në zhvillim dy deponi të mëdha që do të trajtojnë vetëm mbeturinat inerte – deponitë e para në Kosovë që e bëjnë këtë. I gjithë objekti do të rrethohet dhe do të pranohen lëndët e para. E gjithë kjo do të ofrohet me një çmim më të ulët se ai që ofrojnë aktualisht bizneset e tjera. Do të pranojmë mbeturina nga të gjithë qytetarët.”**

Për t'iu përgjigjur më mirë sfidave të lidhura me energjinë, pjesëmarrësit nga OJQ-të rekomanduan bashkimin e tregut të energjisë me atë të Shqipërisë, sepse Shqipëria thuhet se prodhon 100% të energjisë elektrike nga burime të ripërtërishme, kryesisht hidrike. Një tjetër rekomandim ishte një taksë karboni, për të inkurajuar dekarbonizimin.

Më tej, një nga pjesëmarrësit në një diskutim në grup të fokusit përmendi një taksë ekologjike, e cila ai tha se ekziston në Kosovë dhe qytetarët e paguajnë; ai shtoi, megjithatë, se nuk ka të dhëna se sa para janë mbledhur nga kjo taksë dhe sa janë përdorur për investime në projekte mjedisore. Veç kësaj, studimi i vlerësimit të nevojave për të vlerësuar kapacitetet e Kosovës në burime ujore dhe të erës duhet të vijë përpara kërkesave për ndalimin e thëngjillit. OJQ-të mendojnë se megjithëse ndalimi i djegies së thëngjillit mund të jetë një hap pozitiv, ai gjithashtu mund t'i shtyjë qytetarët të përdorin më shumë dru zjarri dhe të çojë në shpyllëzim të mëtejshëm; pyjet tashmë janë të pamjaftueshme dhe të degraduara.

## **Përfundime dhe rekomandime**

Ky seksion synon të theksojë disa sugjerime të ofruara nga pjesëmarrësit që përfaqësojnë palët relevante të interesit.

Në përgjithësi, nuk është i lartë të kuptuarit e publikut për ndryshimet klimatike. Të anketuarit në përgjithësi pohuan se kanë njohuri mesatare rreth kërcënimeve të mundshme

shëndetësore të shkaktuara nga ndryshimet klimatike. Është i ulët vetëdijesimi në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Shumica e të anketuarve kanë dëgjuar për ndryshimet klimatike, dhe rreth 70% e tyre do ta mbështesnin vlerësimin institucional të ndikimit të ndryshimeve klimatike në shoqërinë kosovare. Nga përgjigjet e tyre, është e qartë se qytetarët nuk janë të vetëdijshëm për ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe as shkencën që qëndron pas ndryshimeve klimatike dhe se si ato manifestohen në sektorë të ndryshëm. Duke qenë se shumica e të anketuarve kanë prioritet menaxhimin e mbeturinave dhe çështjet mjedisore të lidhura me mbeturinat si kërcënimet më serioze mjedisore në kuadrin e zbutjes së kërcënimeve mjedisore, duket se publiku është më i shqetësuar për çështje që janë më të prekshme dhe që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre. Kishte miratim të përgjithshëm për vendosjen e gjobave për hedhjen e mbeturinave dhe tarifave për qese plastike.

Përkundër vetëdijesimit mesatar për ndryshimet klimatike, fakti që qytetarët më së shumti dëgjojnë për të përmes televizionit ose rrjeteve sociale mund të jetë arsyeja pse ata nuk i kanë kuptuar ndikimet reale të ndryshimeve klimatike dhe përpjekjet më të përshtatshme zbutëse. Nëse do të kishte më shumë fushata vetëdijesimi publik, publiku do të ishte më i vetëdijshëm për ndikimet e ndryshimeve klimatike në sektorë të ndryshëm dhe do të mbështeste përpjekje më të përshtatshme zbutëse.

Për sa i përket mbështetjes së tyre për masën e dytë më efektive zbutëse, reduktimin e përdorimit të lëndëve djegëse fosile, shumica e qytetarëve u përgjigjën pozitivisht ndaj tarifave më të larta të energjisë elektrike nëse kjo nënkuptonte se do të mund të adresoheshin ndryshimet klimatike. Do të ishte interesante të testoheshin kjo pikë duke qenë se tarifat e energjisë elektrike tani janë në rritje për shkak të krizës energjetike, pavarësisht nga tranzicioni i energjisë apo kalimi në burimet e ripërtërishme të energjisë.

Ishin relativisht të larta vetëdijesimi dhe njohuritë e institucioneve qendrore dhe lokale për ndikimin e ndryshimeve klimatike në shoqëri dhe shëndetin publik. Institucionet qendrore ishin gjithashtu të vetëdijshme për sfidat e ndryshimeve klimatike në Kosovë dhe risqet që lidhen me to. Institucionet pohuan se kanë bërë disa përparime në adresimin e ndryshimeve klimatike. Megjithatë, ata përmendën se ndonjëherë kufizimet buxhetore e pengojnë arritjen e objektivave. Prandaj nevojiten më shumë investime për t'i trajtuar ndryshimet klimatike.

Sektori privat është gjithashtu i vetëdijshëm për efektet e ndryshimeve klimatike. Ata e kuptojnë se si bizneset dhe operacionet e tyre ndikojnë negativisht në mjedis. Disa prej tyre u shprehën se po punojnë për minimizimin e ndotjes dhe se nevojitet më shumë mbështetje institucionale në këtë drejtim. Në fund, përfaqësues të shoqërisë civile deklaruan se po bëjnë sa munden për frenimin e efekteve të ndryshimeve klimatike, por se duhet bërë më shumë nga të gjithë aktorët.

Gjetjet synojnë të informojnë zhvillimin e nismave dhe strategjive të politikave dhe të inkurajojnë ndryshimin e sjelljes në komunitete për t'i përballuar më mirë ndryshimet klimatike dhe për t'i minimizuar risqet shëndetësore. Rezultatet mund të kontribuojnë në diskutimet publike ndërmjet qytetarëve, institucioneve qendrore dhe lokale, komunitetit të biznesit dhe organizatave të shoqërisë civile, çka do t'u ndihmonte t'i targetonin më mirë

intervenimet e tyre. Sugjerimet dhe pikëpamjet e mëposhtme u ndanë në diskutimet në grupe të fokusit nga përfaqësues të bizneseve, organizatave joqeveritare dhe institucioneve publike.

- » Nevojiten më shumë të dhëna për kapacitetin dhe potencialin për të gjeneruar energji nga burime alternative si era. Përveç shtimit të fondeve, nevojitet më shumë angazhim institucional në bashkëpunim me investitorët potencialë (sektori privat) për burimet alternative.
- » Bizneset theksuan se për të rritur kapacitetet e tyre prodhuese, për të adoptuar teknologji më të avancuara dhe për të investuar në panele solare, institucionet qendrore të Kosovës duhet t'u ofrojnë mbështetje financiare.
- » Bizneset sugjeruan që institucionet e nivelit qendror të ndryshojnë politikat fiskale, duke e rritur në 500 kW kufirin prej 100 kW për transferimin e energjisë elektrike nga prodhuesit privatë në rrjet.
- » Kaldajat elektrike duhet të ndalohen dhe të zëvendësohet me pompa nxehtësie.
- » Në komuna duhet të kryhet një studim i vlerësimit të nevojave, duke nxitur instalimin e paneleve fotovoltaike ose pompave të nxehtësisë.
- » Ligji për Energjinë duhet të ndryshohet për të lejuar më shumë investitorë të investojnë në Kosovë.
- » Komunitat duhet të hartojnë strategji për Qytete të Mençura që do të ofronin alternativa transporti ndaj automjeteve me naftë.
- » Duhet të organizohen fushata për të rritur vetëdijesimin e publikut për eficiencën e energjisë.
- » Nevojiten më shumë investime dhe vëmendje për energjinë diellore dhe energjinë hidrike.
- » Kosova duhet të zbatojë një politikë për ndalimin e qeseve plastike ose të miratojë një politikë të përdorimit të qeseve plastike me pagesë.
- » Institucionet qendrore duhet t'i mbështesin prodhuesit dhe t'i stimulojnë bizneset për të mbrojtur mjedisin.
- » Shumica e pjesëmarrësve të grupeve të fokusit përmendën barnat e hedhura të skaduar si një nga ndotësit. Prandaj, rregulloret ligjore që kërkojnë djegien e barnave të skaduar duhet të zbatohen në mënyrë rigoroze.
- » Organizatat ndërkombëtare mund të mbështesin institucionet qendrore duke ofruar më shumë ekspertizë për ndryshimet klimatike.
- » Ekziston nevoja për një landfill të veçantë për mbeturinat e kafshëve.
- » Buxheti i shtetit duhet të planifikohet më mirë dhe të harmonizohet me objektivat e përcaktuara në dokumentet e politikave.
- » Duhet të inkurajohet shkëmbimi i njohurive dhe shkathtësive me bizneset e tjera evropiane.

## Lista e referencave

1. Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, NENI 1 PËRKUFIZIMET
2. Hayes K, Blashki G, Wiseman J, Burke S, Reifels L., 'Ndryshimet klimatike dhe shëndeti mendor: risqet, ndikimet dhe veprimet prioritare', revista Ndërkombëtare e Shëndetit Mendor 2018
3. Semple, EC, Kufiri i barrierës së pellgut të Mesdheut dhe thyerjet e tij veriore si faktorë në histori, Ann. Assoc. Am. Geogr. 1915.
4. Virta Global, Çka është dekarbonizimi dhe pse na duhet urgjentisht?, 2014
5. Shmangia e ndryshimeve të rrezikshme klimatike
6. Joachim, H., Cramer., Wolfgang, et al, Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), Simpoziumi Ndërkombëtar për Stabilizimin e Përqendrimeve të Gazrave Serë, Shmangia e Ndryshimeve të Rrezikshme Klimatike, 2005
7. Analitika e Klimës, Gjurmuesi i Veprimit për Klimën, Përditësimi Global i Parashikimeve të Ngrohjes, maj 2021
8. UNFCC, Marrëveshja e Parisit, 2015, marrë nga [https://unfccc.int/sites/default/files/english\\_paris\\_agreement.pdf](https://unfccc.int/sites/default/files/english_paris_agreement.pdf)
9. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, OKB, marrë nga <https://www.un.org/sustainabledevelopment/climate-change/>
10. Bashkimi Evropian, Marrëveshja e Gjelbër Evropiane, dhjetor 2019, marrë nga [https://ec.europa.eu/clima/eu-action/european-green-deal\\_en](https://ec.europa.eu/clima/eu-action/european-green-deal_en)
11. Kalim në të Gjelbër, Marrëveshja e Gjelbër me BE-në – një udhërrëfyes drejt ekonomive të qëndrueshme, marrë nga <https://www.switchtogreen.eu/the-eu-green-deal-promoting-a-green-notable-circular-economy/>
12. Grupi për Strategji, Përpjekjet e Singaporit dhe ndërkombëtare, marrë nga <https://www.nclimatechanges.gov.sg/singapores-climate-action/singapore-and-international-efforts/>
13. Vukovic, A., Vujadinovic., M., Studim për Ndryshimet Klimatike në Rajonin e Ballkanit Perëndimor, 2018, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
14. Banka Botërore, Kosovë - Një e ardhme me Transport të Gjelbër dhe Ajër të Pastër, 2019
15. Organizata e Kombeve të Bashkuara, Kosovë, një nga pikat e nxehta nëpër botë: si i lufton një ambasadore e re për klimën ndryshimet klimatike në Ballkanin Perëndimor, tetor 2021
16. Qeveria e Kosovës, Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019-2028, 2018, marrë nga [https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/14-13-59-04102018/Climate%20Change%20Strategy%20\\_sep\\_020.pdf](https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/14-13-59-04102018/Climate%20Change%20Strategy%20_sep_020.pdf)

## Aneksi I Metodologjia

### Metodologjia cilësore

për të kryer analizën e pulsit publik në mesin e institucioneve qendrore të Kosovës, bizneseve dhe qytetarëve (të përfaqësuar nga OJQ-të/OSHC-të) u përdor një qasje e përzier për të identifikuar sfidat e veçanta të ndryshimeve klimatike me të cilat përballet Kosova, si dhe mundësitë dhe iniciativat për kalimin në një ekonomi neutrale ndaj karbonit përmes dekarbonizimit. Qëllimi ishte të kapeshin këndvështrimet e palëve të interesit për tejkalimin e pengesave ligjore, institucionale dhe ekonomike ndaj investimeve me karbon të ulët, përmes diskutimeve në grupe të fokusit (GF) të plotësuar nga rezultatet e Përmbledhjes së Pulsit Publik XXII për ndryshimet klimatike.

U zhvilluan shtatë (7) diskutime të GF:

- një (1) me institucionet qendrore dhe një (1) me institucionet lokale; tre (3) me biznese
- një (1) me OSHC nacionale dhe një (1) me OSHC lokale.

IDRA, konsulenti zbatues, ndërmori gjithashtu hapat e mëposhtëm me anketën.

- Është bërë një SHQYRTIM i literaturës që mund të jetë relevante për projektin, duke përfshirë strategjitë, legjislacionin dhe dokumentet tjera kyçe, si dhe hulumtimet e mëparshme PËR këtë temë në Kosovë, rajon dhe më gjerë. Pjesa më e madhe e informacionit nga hulumtimi është përfshirë në raportin përfundimtar, por gjithashtu ka formësuar metodën, procedurën e mostrimit dhe më e rëndësishmja, pyetëtorët e grupeve të fokusit.
- Profilizimi i pjesëmarrësve u bë përmes një kontrolluesi të rekrutimit. Këto të dhëna mundësonin përzgjedhjen e pjesëmarrësve më të përshtatshëm për të përmbushur objektivat hulumtuese të secilit GF;
- U përgatitën përshkrime për t'u ndihmuar studiuesve të mbledhin informacion mbi temat e eksploruara dhe t'i kategorizojnë ato për qëllime analitike.
- Raporti analitik përfshin informacion nga të gjitha GF-të, eksploron çështjet më të zakonshme në më shumë detaje, përmbledh gjetjet dhe ofron rekomandime aty ku është e mundur.

### Kontrolluesi i rekrutimit

- Transkripti dhe gjetjet kyçe
- Përgatitja e instrumenteve hulumtuese
- Raport për gjetjet e GF dhe analiza e të dhënave të anketës
- Për të siguruar cilësinë e të dhënave, për procesin e rekrutimit u përdor një pyetësor kontrolli për të identifikuar pjesëmarrësit me profilin e duhur në GF.



## Procesi i rekrutimit dhe procedurat e pëlqimit

Procesi i rekrutimit filloi menjëherë pas shqyrtimit dhe finalizimit të kontrollit të rekrutimit. Koordinatorët identifikuan kandidatët e mundshëm dhe përcaktuan pranueshmërinë e pjesëmarrësve për të marrë pjesë në GF/intervistat përmes kontrolluesve. Kontrolluesit e plotësuar me informacionin e kontaktit të pjesëmarrësve/të intervistuarve potencialë të grupit të fokusit u dërguan te koordinatorët dhe menaxheri i projektit për një raund të dytë filtrimi. Vetëm kandidatët më të përshtatshëm për të marrë pjesë në diskutime në GF/intervista u kontaktuan dhe u ftuan të merrnin pjesë në grupe.

Pjesëmarrësit/të intervistuarit dhanë pëlqimin për pjesëmarrjen nëpërmjet telefonit ose emailit, pas një ftese që detajonte qëllimin e GF/intervistës dhe faktin që ajo do të regjistrohej për transkriptim dhe do të përdorej vetëm nga stafi hulumtues i IDRA-s. Pjesëmarrësit nënshkruan formularët e pëlqimit pas mbërritjes për GF ose kur erdhën intervistuesit. Formularët mund të gjenden në seksionin Format e Pëlqimit.

## Metodologjia sasiore

Pjesa sasiore e hulumtimit është nxjerrë nga seksioni i Pulsit Publik për ndryshimet klimatike, i cili është realizuar me publikun e gjerë në Kosovë.

## Peshimi i totaleve të popullatës

Anketat e Pulsit Publik marrin mostra më të mëdha të pakicave në mënyrë që të dhënat të mund të zërthehen sipas përkatësisë etnike. Megjithatë, kur bëhen përlogaritjet për totalet, ekipi i Pulsit Publik bën peshimin e të dhënave sipas shifrave aktuale të popullatës. Që nga viti 2002, janë përdorur përqindjet e mëposhtme për peshimin e totaleve të popullsisë:

- Shqiptarë të Kosovës: 88%;
- Serbë të Kosovës: 6%;
- Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës: 6%.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 dhe të dhënave zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përbërja etnike aktuale në Kosovë është siç vijon:

Përkatësia etnike	Gjithsej popullsia	Përqindja e popullsisë totale
Shqiptarë të Kosovës	1,616,869	92.93
Serbë të Kosovës	25,532	1.47
Turq të Kosovës	18,738	1.08
Boshnjakë të Kosovës	27,533	1.58
Goranë të Kosovës	10,265	0.59
Romë të Kosovës	8,824	0.51
Ashkali të Kosovës	15,436	0.89
Egjiptas të Kosovës	11,524	0.66
Tjetër, refuzon/NP	5,104	0.29
Gjithsej	1,739,825	100.00

Nëse këto shifra do të ndiqeshin për Anketat e Pulsit Publik, peshimi do të ishte si më poshtë:

- Shqiptarë të Kosovës: 93%;
- Serbë të Kosovës: 2%;
- Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (ashkali të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës): 4%.

